



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister

RAPORTI I PUNËS
I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

(Qershor-Dhjetor 2020)

Ky raport paraqet punën e Qeverisë së Kosovës, nga dita e votimit të saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 3 qershor 2020, deri më 30 dhjetor 2020.

Prishtinë, Janar 2020

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Menaxhimi i Pandemisë COVID 19 dhe Rimëkëmbja Ekonomike.....	5
1.1. Menaxhimi i Pandemisë COVID-19.....	5
1.2. Rimëkëmbja ekonomike	10
2. Qeverisja, reforma institucionale dhe kohezioni shoqëror	15
3. Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm.....	19
4. Drejtësi e pavarur dhe efikase	28
5. Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë.....	33
6. Arsimi dhe shkencë.....	36
7. Shëndetësia	39
8. Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	42
9. Infrastruktura, energjia, minierat, ujërat dhe ambienti	45
10. Mbrojtja dhe siguria publike	51
11. Mbrojtja sociale dhe integrimi në punësim	54
12. Kultura, rinia dhe sporti	57
Shtojca I: Të dhënat për COVID-19 Qershor - Dhjetor 2020	60
Shtojca II: Lista e projektligjeve të miratuara nga Qeveria: Qershor – Dhjetor 2020	100

Përmbledhje ekzekutive

Prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë periudhës qershor-dhjetor të vitit 2020, të theksuara në Raportin e Punës, kanë qenë lufta kundër pandemisë Covid-19, rimëkëmbja ekonomike pas kësaj pandemie, forcimi i shtetit, integritetit dhe sovranitetit, avancimi i demokracisë, luftimi i dukurive negative, veçmas krimin dhe korrupsionit, marrja e përgjegjësisë kushtetuese për të qarë përpara procesin e dialogut në bashkëpunim me BE-në dhe SHBA-të mbi parime të qarta, si dhe avancimi i procesit të integrimit evropian.

Në betejën kundër pandemisë Covid-19, janë bërë përpjekjet e duhura për mobilizimin e sistemit shëndetësor dhe të infrastrukturës mbështetëse për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të trajtuar rastet e prekura. Nëpërmjet riorganizimit dhe menaxhimit më të mirë të hapësirave aktuale të institucioneve shëndetësore, është rritur kapaciteti spitalor për trajtimin e të prekurve nga virusi, si dhe janë forcuar kapacitetet rajonale të mbikëqyrjes epidemiologjike përmes qendrave të monitorimit periferik, me shpërndarje në gjithë territorin.

Me qëllim të tejkalimit të pasojave që ka shkaktuar pandemia, Qeveria ka aprovuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19, si dhe ka zhvilluar masat për rimëkëmbje ekonomike që kapin vlerën prej 365 milionë euro. Këto masa përfshijnë: lehtësimin e qasjes në kredi për ndërmarrje private për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit, lehtësimin e barrës tatimore për bizneset, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër, masa për mbështetje të punësimit, masa për mbështetje në zhvillim të bujqësisë, stimulim të kërkesës agregate, mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësisë strategjike, rishikimi të buxhetit për 2020 dhe relaksim të kufizimeve fiskale si dhe të kufirit të borxhit publik, masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar si dhe mobilizim të fondeve për mbështetje ekonomike.

Në politikën e jashtme, Qeveria ka arritur që brenda kësaj periudhe t'i rivendosë marrëdhëniet e ngushta me vendet mike, në rend të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet kryesore të Bashkimit Evropian, të cilat kanë qenë të dëmtuara. Si rrjedhojë, në takimin e 4 shtatorit 2020 në Shtëpinë e Bardhë, në prani të Presidentit Donald Trump, është nënshkruar marrëveshja e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike me Serbinë, e cila paraqet një hap shumë

të rëndësishëm drejt marrëveshjes finale me Serbinë. Më 4 shtator 2020, në Shtëpinë e Bardhë, Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanjahu, njoftoi se Izraeli ka vendosur ta njohë Republikën e Kosovës, ndërsa Qeveria e Kosovës shprehu gatishmërinë për vendosjen sa më të shpejtë të marrëdhënieve bilaterale dhe shkëmbimin e ambasadorëve.

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë një sërë masash dhe veprimesh në sektorët e bujqësisë, drejtësisë, punësimit, financave, administratës publike, infrastrukturës, energjisë, kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe të gjithë sektorëve të zhvillimit, të cilat janë të theksuara në këtë Raport të Punës. Po ashtu, në fund të Raportit, është hartuar shtojca me të gjitha të dhënat e hollësishme për COVID-19, gjatë periudhës qershor-dhjetor 2020.

1. Menaxhimi i Pandemisë COVID 19 dhe Rimëkëmbja Ekonomike

1.1. Menaxhimi i Pandemisë COVID-19

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të qytetarëve dhe bizneseve, për përballje me pandeminë COVID-19, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje, përfshirë reagimin në kohë dhe sigurimin e kushteve sa më të mira shëndetësore. (Si plotësim, shih edhe pjesët tjera, respektivisht pjesën e shëndetësisë dhe Shtojcën 1 për të dhënat për COVID-19 në Kosovë Qershor - Dhjetor 2020.)

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përballje me pandeminë COVID-19, janë si në vijim:

- Është prezantuar Manuali për mbrojtje nga përhapja e COVID-19, që ka shërbyer dhe shërben për udhëzimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës, për kujdes dhe mbrojtje nga COVID-19. Si një dokument dinamik që do të përditësohet varësisht nga situata epidemiologjike dhe vlerësimi i rrezikut.
- Është miratuar Udhëzimi Administrativ (në shëndetësi) nr. 03/2020 - Për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 08/2017 – Organizimi, Struktura, Përcaktimi i Shërbimeve dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), për mundësinë që testimet serologjike për antitropa për detektim të SARS COV-2, të kryhen në KPSH dhe në sektorin privat.
- Është miratuar Plani për Parandalim dhe Kontroll të Covid-19, versioni 2.0, që ka për qëllim një përgjigje sa më adekuate ndaj pandemisë Covid-19 në fazat e ardhshme.
- Sa i përket ngritjes së kapaciteteve spitalore, janë mobilizuar përveç Klinikës Infektive në QKUK, Klinikës së Pulmologjisë, Mjekimit Intensiv Qendror dhe Klinikës së Pediatriisë (rastet Covid tek fëmijët) edhe klinikat COVID 3 dhe Mjekësia Sportive - COVID 4 si dhe 7 spitalet e përgjithshme. Ndërsa në QKUK, janë vendosur tri nga pesë pajisje Rentgen digjital mobil, për trajtimin e pacientëve me COVID-19, ndërsa nga një pajisje e këtij lloji është vendosur në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit dhe atë të Gjilanit.

- Për qëllim të rritjes së kapaciteteve njerëzore, janë rekrutuar 200 specialistë shëndetësorë (100 mjekë - në mesin e të cilëve edhe mikrobiologë, 62 infermierë, 20 inspektorë sanitarë, 4 specialistëve të mikrobiologjisë, 8 laborantë dhe 6 persona-staf teknik mbështetës).
- Është shpallur dhe realizuar me sukses konkursi për 1 mijë e 500 specializantë, duke përfshirë këtu edhe rreth 70 vende për kuadrin nga Lugina e Preshevës.
- Nëpërmjet riorganizimit të Projektit të Shëndetësisë Kosovare (huamarrja nga Banka Botërore) janë rekrutuar 375 profesionistë të fushave të ndryshme mjekësore dhe staf mbështetës, në funksion të fuqizimit të kapaciteteve njerëzore profesionale kundër Covid-19.
- Me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, ka hapur konkurs për rreth 150 specialist të pa punë për lëmi të ndryshme mjekësore, në synimin e MSh-së për të mos lënë asnjë specialist apo mjek të papunë në Kosovë.
- Është arritur pajtimi për pagesat shtesë për të punësuarit në institucionet shëndetësore, të cilët përfshijnë tri nivelet e përkujdesjes shëndetësore, deri në fund të vitit 2020, bazuar në ligjin Anti Covid, për muajt shtator-dhjetor të jenë si në vijim: Mjekët – 250 euro në muaj, Infermierët – 150 euro në muaj, Stafi mbështetës – 100 euro në muaj.
- Më 18 dhjetor është hapur konkurs për rekrutimin e 33 profesionistëve shëndetësor (20 infermierë dhe 13 staf teknik mbështetës).
- Është miratuar Plani i Veprimit për Procedurat e Testimit për Covid-19, që si objektivë e ka rritjen e mbulueshmërisë së shkallës së testimeve në popullatë.
- Janë siguruar 7 aparate për PCR teste: 1 për IKSHPK-në dhe gjashtë (6) për Qendrat rajonale të Shëndetësisë publike: Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë, ku edhe janë dërguar këto aparate (PCR) për kryerje të testimeve molekulare.
- Gjithashtu, edhe aparaturat për testime serologjike për antitrupta (IgG dhe IgM) janë blerë dhe sjellë në IKSHPK, duke rritur fuqinë testuese për diagnostikim të COVID-19, por edhe të hulumtimit rreth statusit imunologjik të popullatës kundrejt infeksionit COVID-19.
- Mbështetja për sektorin e shëndetësisë është koordinuar me efikasitet të lartë dhe në këtë kuadër janë arritur dhe konkretizuar një sërë marrëveshesh me partnerët ndërkombëtarë:
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, për përballje me COVID-19, në kuadër të takimit të përbashkët të dy qeverive respektive Kosovë – Shqipëri.

- Është nënshkruar me Ambasadën e Zvicrës në Kosovë, Marrëveshja e Bashkëpunimit për shërbime shëndetësore cilësore, më të qasshme për qytetarët e Kosovës, në vlerë prej 8.2 milion euro.
- Është nënshkruar me UNOPS-in, Marrëveshja për të ndihmuar sistemin shëndetësor të Kosovës për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit ndërkombëtar, në vlerë prej 14 milionë euro, ndërsa nënshkrimi parasheh aprovimin për transferim për UNOPS-in të shumës prej 8 milionë euro.
- Është nënshkruar marrëveshja për grantin prej 800 mijë euro, ndihmë e Japonisë për shëndetësinë në Kosovë.
- Janë pranuar donacionet e BE-së në QKUK në Klinikën e Onkologjisë. Pjesa e tretë e donacionit përbëhet nga 127 monitorë të pacientit me pesë parametra, 75 pompa infuzive, 75 perfuzomatë – shiringë, pompa, 100 shtretër për kujdes intensiv, 10 autoambulanca - Advanced Life support, plotësisht të pajisura; dhe 7 mijë litra dezinfektues për duar, të cilat u dedikuan menjëherë për Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.
- Ministria e Shëndetësisë është në procedura edhe të blerjes së 300 mijë testeve PCR përmes një tenderi publik, ndërsa përmes UNOPS-it do të sigurohen edhe 100 mijë teste të tjera, me qëllim të krijimit të një stabiliteti të stokut të testeve për gjithë pjesën e parë të vitit 2021.
- Është konfirmuar cilësia maksimale dhe besueshmëria e plotë e testeve të kryera në IKShPK. IKShPK, Departamenti i Mikrobiologjisë, këtë vit mori pjesë në tri kontrolle të jashtme të kualitetit për testimin molekular me RT PCR, dy për Sars-CoV-2 dhe një për Influcençën. Dy kontrolle janë organizuar nga OBSH-ja dhe një nga Instituti “Pastuer” në Paris (përmes projektit Medilab Secure dhe QCMD – Quality Control for Molecular Diagnostics, në Skoci).
- Në EQA 1 (external quality assessment) për detektim të Sars-CoV-2 me Real Time PCR, të organizuar nga OBSH-ja në prill 2020, pesë mostrat e dërguara ishin të detektuara 100%
- Janë pranuar 15 mijë pako për testim të Covid-19 në IKShPK. Në këtë aktivitet, tre afaristë shqiptarë që veprojnë në Gjermani: Lazim Destani (Ecolog), Remzi Ejupi (Eurokoha) dhe Nazim Viqa (AWR Abbruch) i dorëzuan IKShPK-së një donacion me 15 mijë pako për teste të Covid-19 (innuPREP Virus TS RNA kit), të cilat do të ndihmojnë procesin e testimeve kundër virusit Corona në Kosovë.

- Është nënshkruar memorandumi me organizatën “Qatar Charity” në prani të Ambasadorit të Shtetit të Katarit z. Ali bin Hamad Al-Marri, me të cilën në IKSHPK janë pranuar 6 mijë e 500 testeve (RT-PCR) për diagnostikimin e Covid-19 dhe 6 respiratorë.
- Është pranuar donacioni nga zyra e BE-së që përmban 6 mijë komplete testimi për COVID-19, 90 shtretër spitalorë, mbi 67 mijë maska të frymëmarrjes dhe pajisje të tjera mjekësore për luftimin e COVID-19 në Kosovë. Dërgesa përfshiu edhe 350 oksimetra pulsi në gisht dhe 5 defibrilatorë me pacemaker dhe karrocë.
- Është pranuar asistencë teknike nga Japonia në vlerë prej 700 mijë dollarësh, për t’u përballur me luftën kundër Covid-19.
- Është pranuar donacioni nga Gjermania i 6 mijë testeve RT-PCR, për diagnozë laboratorike të Covid-19, në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik/ IKSHPK.
- Është pranuar kontingjenti prej 30 ventilatorësh, 200 pulsiksometra dhe 20 makina elektrokardiografike, si donacion i Bashkimit Evropian.
- Janë pranuar 40 pajisjeve oksigjeno-formuese, donacion nga Qeveria e Luksemburgut dhe UNICEF.
- Është pranuar donacioni në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar në Prishtinë nga Zyra për Bashkëpunim dhe Mbrojtje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, në vlerë prej 103 mijë euro që përmban: kosha të mbeturinave spitalore me pedale, kosha të mbeturinave spitalore për mbeturina të kontaminuara të rrezikshme, kosha për mbeturina të rrezikshme, koshat për mbeturina infektive (të rrezikshme), mbajtës / karrocë të mbeturinave metalike për materiale të rrezikshme, kontejner mobil të mbrojtur dhe me pedale për mbeturina radioaktive, kontejner të mbeturinave me mbrojtës dhe me pedale dhe mbrojtës shiringash.
- Janë pranuar donacionet me pajisje mjekësore nga UNICEF-i prej 7.4 tonelatave, që do të ndikojë në përmirësimin e furnizimeve në të gjitha komunat dhe shërbimet klinike.
- Është pranuar donacioni prej 50 ventilatorësh/respiratorësh, ndihmë kjo nga Ambasada e SHBA-ve dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).
- Është pranuar donacioni nga Organizata Botërore e Shëndetësisë/OBSh, ku iu dhuruan Qendrës Klinike Universitare të Kosovës/QKUK, edhe 238 oksigjeno-koncentratorë.
- Është pranuar donacioni nga Japonia, me vlerë mbi 700 mijë dollarë që përfshinë 12 mijë e 200 tableta të medikamentit Avigan (Favipiravir).

- Është bërë dorëzimi i reagjentëve në Laboratorin e Mikrobiologjisë në QKUK, me vlerë mbi 3 milion euro, të financuara nga “Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor” (AICS), në kuadër të projektit “Mbështetje për sistemin shëndetësor në Kosovë”.
- Janë pranuar 15 respiratorë për QKUK-në nga Gjermania, me vlerë prej rreth 500 mijë euro.
- Është pranuar Skaneri i tomografisë kompjuterike (CT) për Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet Komandës ushtarake për Evropë.
- Është bërë sigurimi i vaksinës së gripit sezonal si dhe janë bërë përgatitjet e nevojshme për sigurimin e vaksinës kundër COVID 19, në koordinim me partnerët zhvillimor:
- Me qëllim të parandalimit të Gripit sezonal, Qeveria e Kosovës ka blerë përmes UNICEF-it 165 mijë vakcina katërvalente.
- Në proces është edhe sigurimi i 50 mijë vaksinave të tjera me çka ngritet për 100% numri i vaksinave, krahasuar me vitin paraprak
- Është nënshkruar aplikimi zyrtar i Kosovës për sigurimin e vaksinës kundër COVID-19 në aleancën globale GAVI, që ka ngritur mekanizimin – COVAX. Fillimisht janë planifikuar 740 mijë doza të vaksinës ku do të vaksinohet rreth 20% e popullatës (PERMES GAVI).
- Njëkohësisht është bërë planifikimi i vaksinimit masiv (30%) të popullatës në Kosovë 2021-2022 me vaksinën kundër COVID-19 ku planifikohen (522.957x2 doza) 1 milion e 45 mijë e 914 doza të vaksinës.
- Janë identifikuar grupacione të caktuara të popullatës të cilët duhet të vaksinohen me vaksinën kundër COVID-19. Në programin e vaksinimit kundër COVID19, vakcina do të ju ofrohet grupeve me prioritet të lartë si:
 - Punëtorëve shëndetësorë,
 - Të gjithë personave mbi 65 vjeç,
 - Të gjithë personave me rrezik të lartë: si:
 - *me sëmundje kronike të traktit respiratorë, siç janë astma, sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (COPD) ose bronkitet*
 - *me sëmundje kronike të zemrës,*
 - *me sëmundje kronike të veshkave,*
 - *me sëmundje kronike të mëlçisë,*

- *me sëmundje kronike neurologjike, siç është sëmundja e Parkinsonit ose sëmundje tjera neurologjike,*
- *me aftësi të kufizuara,*
- *me diabet*
- *disfunksion splenik ose aspleni*
- *ata me sistem imunitar të dobësuar*
- *personat obez (i përcaktuar si BMI i 40 dhe më lart)*
- Anëtarët e familjes të atyre pacientëve me rrezik të lartë,
- Ata persona që kujdesen për të moshuarit ose ndaj personave me aftësi të kufizuara, mirëqenia e të cilit mund të rrezikohet,
- Punëtorët që ofrojnë shërbime në një shtëpi të pleqve ose qendër rehabilituese, të cilët janë të përfshirë direkt në kujdesin e pacientë /personit të cenusshëm të cilët janë në rrezik të shtuar nga ekspozimi ndaj gripit,
- Punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe punëtorët social siç janë asistentët personal, që bëjnë përkujdesje familjare për pacientët me nevoja të veçanta.
- Personat e moshës mbi 40 vjeç
- Punëtorët e arsimit
- Policia, ushtria dhe stafi në institucione të rëndësishme shtetërore, Punëtorët e sektorit publik.

1.2. Rimëkëmbja ekonomike

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të qytetarëve dhe bizneseve pas dëmeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19, ka ndërmarrë një sërë masash nëpërmjet të cilave është përmirësuar aktiviteti ekonomik, të hyrat familjare, formalizimi dhe qëndrueshmëria e punësimit. (Si plotësim, shih edhe pjesët tjera, respektivisht pjesën e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, bujqësinë dhe zhvillimin rural, mbrojtjen sociale dhe integrimin në punësim, si dhe kulturë, rini dhe sporti.)

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është rishikuar Ligji për ndarjet buxhetore për vitin 2020 i cili adreson të gjitha sfidat e krijuara nga pandemia e virusit COVID-19 dhe gjen mënyra të financimit të realizimit të programit qeverisës. Përmes këtij rishikimi Qeveria e Kosovës ka arritur të mobilizojë 370

milion euro për të mbështetur sektorin privat dhe qytetarët dhe për menaxhim të suksesshëm të pandemisë.

- Me qëllim të reflektimit të ndryshimeve në treguesit kryesorë ekonomikë, si pasojë e situatës pandemike COVID-19, Qeveria e Kosovës ka rishikuar dhe miratuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023.
- Qeveria e Republikës së Kosovës me 13 gusht 2020 ka miratuar Programin për Rimëkëmbje Ekonomike në vlerë prej 365 milionë euro. Ky program gjithëpërfshirës përmban 15 masa të cilat kanë për qëllim zbutjen e ndikimit negativ të pandemisë dhe fillimin e rimëkëmbjes ekonomike
- Ndër të tjera masat përfshijnë: lehtësimin e qasjes në financa (100 milionë); zvogëlimin e barrierës tatimore; subvencionimin e pagave; stimulimin e kërkesës agregate; dyfishimin e subvencioneve në bujqësi; mbështetje për arsimin dhe shëndetësinë; mbështetjen e bizneseve të grave; mbështetjen e komuniteteve; zhvillimin e balancuar rajonal; mbështetjen e ndërmarrjeve publike; mbështetje për komunat; dhe mbështetje për bashkatdhetarët
- Deri tani, rreth 260 milionë euro janë shpërndarë, në mënyrë direkte, në kategori të ndryshme ekonomike:
 - (1) Mbi 28 milionë në Paga dhe Mëditje (shtesat në shëndetësi, polici, etj);
 - (2) Mbi 23 milionë në Mallra dhe Shërbime;
 - (3) Mbi 200 milionë në Subvencione dhe Transfere – pjesa më e madhe subvencione për sektorin privat për t'u përballur më lehtë me pandeminë (masat për subvencionimin e pagave, subvencionimin e qirasë; pastaj subvencionimi prej 60 milionë i bazuar në numrin e punëtorëve, etj)

Nga masa prej 60 milionë Euro kanë përfituar 36 mijë 679 biznese, të cilat kanë deklaruar 206 mijë e 852 të punësuar. Struktura e bizneseve përfituese, siç është prezantuar në Tabelën 1, ilustron që përmes kësaj mase më së shumti kanë përfituar bizneset e vogla të cilat punësojnë prej 1 deri në 50 punonjës (mbi 72% të mjeteve, ndërsa mbi 80% të mjeteve janë ndarë për bizneset që kanë deri në 100 të punësuar).

Tabela 1. Struktura e bizneseve përfituese

Klasifikimi sipas nr. të punësuarve	Nr. i bizneseve	Subvencion i (Mil. Euro)	Nr. i të punësuarve	% subvencionimit
0-10	33,600	27.30	94,090	45.50%
11-50	2,701	16.00	55,162	26.67%
51-100	217	4.37	15,075	7.28%
101-200	102	4.17	14,390	6.95%
201-300	29	2.06	7,104	3.43%
Mbi 301	30	6.10	21,031	10.17%
Total	36,679	60.00	206,852	100.00%

- Një pjesë tjetër e subvencioneve kanë shkuar te grupet me më së shumti nevojë: dyfishimi i asistencës sociale. Mbi 25 mijë familje kanë përfituar nga dyfishimi i asistencës sociale
- Po ashtu, mijëra fermerë në sektorin e bujqësisë kanë përfituar nga dyfishimi i subvencioneve (një pjesë e pagesave ende është në proces)
- Komunitat e Kosovës kanë përfituar 10 milionë euro për përballje me të lehtë me pandeminë
- Sektori i arsimit është mbështetur me 10 milionë (5 milionë për 2020 dhe 5 të tjera për 2021)
- Kultura, sporti, artistët – janë mbështetur me 5 milionë euro
- Ndërmarrje të rëndësishme publike – janë mbështetur me mbi 12 milionë euro
- Në total, përmes Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, mbi 400 mijë qytetarë (punëtorë të sektorit privat, familje në asistencë sociale, mjekë, policë, fermerë, gra në biznes, artistë, sportistë, komunitete, etj) kanë përfituar.
- Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike që do të mundësojë:

- Stimulimin e kërkesës agregate përmes mundësimit të hyrjes së hershme në fondet e TKPK-së (afër 200 milionë)
 - Lehtësimin e qasjes në financa duke rritur mbulimin nga FKGK, dhe duke mbuluar rrezikun e kredisë dhe normat e interesit për bizneset dhe fermerët
 - Mbështetje shtesë për sektorin privat për funksionimin e rregullt dhe rritjen e investimeve
 - Mbështetje për ata që kanë humbur vendin e punës si rezultat i pandemisë
 - Zvogëlimin e barrës tatimore për industrinë e shërbimeve duke aplikuar normën e TVSH-së së zvogëluar prej 8% për hotelet dhe gastronominë
 - Largimin e TVSH-së për lëndët e para të prodhuara në Kosovë (të përdorura në procesin e prodhimit)
 - Largimin e TVSH-së për produktet e sigurimeve bujqësore
- Në kuadër të Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar, janë përmbyllur procedurat për nënshkrimin e 9 marrëveshjeve në vlerë financimi prej rreth 250 milionë euro, ku 213 milionë euro janë financim për luftën ndaj pandemisë COVID-19: Marrëveshja me Bankën Botërore në vlerë prej 46 milionë euro për “Projektin Emergjent COVID-19 për Kosovën”, Asistenca Marko-financiare me Bashkimin Evropian në vlerë prej 100 milionë eurosh; Marrëveshja me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “Reagimi Emergjent ndaj COVID-19” në vlerë prej 35 milionë euro; Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për “Financimin Emergjent të Infrastrukturës Vitale” në vlerë prej 30 milionë euro, dhe marrëveshje të tjera të ndërlidhura.
 - Është miratuar Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Projektit Emergjent COVID -19 për Kosovën. Marrëveshja i siguron Republikës së Kosovës një kredi prej 46 milionë euro, me normë të ulët interesi dhe me një periudhë të shlyerjes 20-vjeçare dhe një greis periudhë prej 5 vjetësh.
 - Janë realizuar me sukses katër ankande për letrat me vlerë dhe emetuar letra me vlerë për financimin e buxhetit në vlerë prej 90 milionë euro (duke përfshirë ri-financimin 55 milionë euro).

2. Qeverisja, reforma institucionale dhe kohezioni shoqëror

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, Agjendës për Reforma Evropiane, Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ka ndërmarrë masa për qeverisje të mirë, reformë institucionale dhe kohezion shoqëror.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Janë miratuar 12 akte nënligjore për zbatimin e ligjit për zyrtarët publik dhe në zbatim të ligjit për administratën shtetërore, Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Zyrës së Kryeministrit. Kjo është Rregullorja e parë e miratuar sipas legjislacionit të ri, të cilën Komisioni Evropian e ka vlerësuar si model që duhet të aplikohet nga të gjitha ministratë.
- Me qëllim të avancimit të shërbimeve digjitale është zhvilluar Platforma qendrore për ofrimin e shërbimeve elektronike “eKosova” dhe Platforma e Interoperabilitetit (Government Gateway). Platforma qendrore për ofrimin e shërbimeve elektronike “eKosova” është në fazën e lansimit dhe do të ofroj shërbime elektronike në mënyrë të centralizuar për qytetarët, bizneset dhe vetë administratën. Platforma e interoperabilitetit mundëson ndërlidhjen e sigurt të sistemeve elektronike të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet këtyre sistemeve në kohë reale.
- Është funksionalizuar portali shtetëror për konkurrim, “konkursi.rks-gov.net”, si dhe salla për realizimin e testimit me shkrim në formë elektronik.
- Është përpiluar lista nga skema e bursistëve të programit Young Cell Scheme, raundi i 12-të, me 44 bursistë, nga të cilët 20 kanë pranuar akt emërimet më 16 dhjetor. Po ashtu janë trajnuar 1 mijë e 852 nëpunës civil nga nivelet drejtues, profesional dhe administrativ te nivelit qendror dhe lokal te administratës publike.
- Me qëllim të avancimit të kornizës për planifikim strategjik, është miratuar Koncepti dhe Vendimi për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, që paraqet prioritetet kryesore për të gjithë sektorët për periudhën e ardhshme të planifikimit.
- Është miratuar Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative, në kuadër të agjendës së Rregullimit më të Mirë, dhe zbatimit të Koncept Dokumentit për Zvogëlimin e Barrës Administrative.

- Duke u bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë së Kosovës, janë proceduar në Qeveri për aprovim 29 projektligje dhe 16 akte nënligjore. Disa projektligje të cilat hyjnë në kuadër të agjendës evropiane, janë si në vijim: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L -31 për Liritë Fetare në Kosovë, Projektligji për Aktet Juridike, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/ L- 010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës i cili i ka kaluar të gjitha procedurat është dërguar në Komisionit të Venedikut, i cili në dhjetor ka ofruar rekomandimet për avancimin e këtij projektligji. Ky ligj përbënë një nga reformat më të rëndësishme për të ngritur efikasitetin në funksionimin e Qeverisë, si dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë: gjatë periudhës ky projektligj është finalizuar me të gjitha dokumentet përkatëse dhe i nijeti është i gatshëm për procedim për miratim nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Ka përfunduar Faza I-rë e Raportit mbi Studimin e Fizibilitetit të Vetëqeverisjes Lokale, që ka për qëllim diagnostikimin e sistemit ekzistues të vetëqeverisjes lokale në Kosovë bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe është përfunduar edhe pjesa e studimit për fazën e II-të për Themelimin e Grupit Tematik Punues “Mbikëqyrja e Komunave nga autoriteti Mbikëqyrës”.
- Janë aprovuar kriteret për financim të projekteve të komunave nga programi “komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike”, nga i cili janë financuar 12 projekte në 10 komuna në vlerë prej 573 mijë e 347 euro. Ndërsa nga programi “Bashkëfinancimi me donatorë” për skemën e granteve të bazuar në performancën komunale janë financuar 19 projekte në 12 komuna në vlerë prej 2 milion e 499 mijë e 770 euro.
- Është miratuar Rregullorja e 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit për Performancë Komunale. Bazuar në këtë rregullore, është matur performanca e komunave për vitin 2019.
- Në kuadër të Grantit të Performancës Komunale për vitin 2020, janë financuar 43 projekte të 23 komunave, të cilat i kanë përmbushur kushtet minimale për kualifikim.
- Me qëllim të krijimit të mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimi i mirëqenies sociale Qeveria ka përmbyllur

raundin e përzgjedhjes së OJQ-ve në fushën e barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik të grave dhe parandalimit të dhunës në familje ku janë përzgjedhur 5 OJQ, dhe 7 individë për mbështetje përmes subvencionimit;

- Është hartuar Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të njeriut, i cili do të jetë i shoqëruar me planin e veprimit tre vjeçar (2021-2023) për zbatimin e tij, si një plan horizontal për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Është miratuar Dokumenti i politikave kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike të Republikës së Kosovës, i cili do të shërbejë si udhëzues për parandalimin e të gjitha formave të ngacmimit seksual në administratën publike.
- Është themeluar Grupi Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkanli dhe Egjiptian me qëllim të zbatimit të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në Kuadër të Procesit të Zgjerimit të Bashkimit Evropian e aprovuar nga Kryeministrat e Ballkanit Perëndimor.
- Çështja e personave të zhdukur është trajtuar si çështje me prioritet të veçantë. Është tema e parë e adresuar në ‘dialogun e Brukselit’, po ashtu një nga zotimet e ‘Marrëveshjes së Uashingtonit’. Në këtë kontekst janë ndërmarr këto veprime: (1) janë realizuar gërmimet vlerësuese në nëntë lokacione, nga të cilët tetë lokacione kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore të 11 personave, viktimave të luftës. (2) Në territorin e Serbisë, krahas gërmimeve vlerësuese në lokacionin e varrezës masive në Kizhevak dhe zhvarrosjes së mbetjeve mortore të gjetura deri më tani në këtë lokacion, gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar gërmime vlerësuese edhe në Kozarevë, si dhe një vizitë vlerësuese në një lokacion në Shtaval, të Sijenicës. (3) Në zbatim të Ligjit për Persona të Zhdukur, përkatësisht në respektim të të drejtave të familjarëve të personave të zhdukur, të drejta këto të garantuara edhe me ligj, gjatë kësaj periudhe kohore familjeve u janë kthyer për rivarrim mbetjet mortore të dy personave të zhdukur, të identifikuar. (4) Janë edhe tri identifikime të reja, në bazë të raporteve të ADN-së të dorëzuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur gjatë kësaj periudhe kohore, për të cilat jemi në komunikim me familjet e personave të identifikuar. (5) Në margjina të Planit Kornizë Rajonal, gjatë kësaj periudhe kohore, është mbajtur një takim mes përfaqësuesve të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur të Republikës së Kosovës dhe Komisionit të Serbisë për Persona të Zhdukur.

Më qëllim të mbrojtjes dhe përkrahjes së komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në Kosovë, janë ndërmarrë këto masa:

- Është publikuar shpallja publike “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve” me qëllim të financimit të projekt propozimeve të OJQ-ve dhe Mediave të komuniteteve jo-shumicë. Në kuadër të buxhetit prej 700 mijë euro janë përzgjedhur 49 përfitues OJQ dhe Media.
- Në kuadër të zbatimit të masës 9 të Programit të Rimëkëmbjes ekonomike është publikuar shpallja publike për organizatat joqeveritare dhe bizneset e vogla për ofrimin e ndihmave për personat e rrezikuar nga radhët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, të prekur nga virusi COVID-19. Qëllimi kryesor i kësaj thirrje ka qenë mbështetja e iniciativave dhe projekteve të cilët kanë për qëllim përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës, që janë prekur më së rëndi nga virusi Covid-19, dhe rimëkëmbja e tyre ekonomike. Nga vlera prej 2 milion euro, për furnizim me pako me gjëra elementare ushqimore dhe higjienike për personat më të rrezikuar nga pandemia me COVID 19, buxheti në dispozicion ka qenë 900 mijë euro kurse janë mbështetur financiarisht 49 organizata jo-qeveritare.
- Për ndihmë financiare për ndërmarrjet e vogla dhe biznese familjare, të cilat kanë pësuar nga COVID/19, buxheti në dispozicion ka qenë 800 mijë euro. Gjithsej 199 ndërmarrje të vogla dhe biznese familjare janë përkrahur financiarisht.
- Për ndihmë personave të braktisur, të sëmurë dhe të moshuar në formë të shërbimeve të gerontologjisë, buxheti në dispozicion ka qenë 300 mijë euro. Gjithsej 19 organizata joqeveritare janë përkrahur financiarisht.

3. Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, Agjendës për Reforma Evropiane, Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ka ndërmarrë masa që kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ruajtje të stabilitetit makro-fiskal dhe mbështetje dhe zhvillim të sektorit privat. Masat konkrete përfshijnë avancimin e kornizës ligjore në fushën e zhvillimit ekonomik, partneritetin me partnerët strategjik, inspektimet dhe zhvillimin e balancuar rajonal. Prioritet kryesor i Qeverisë gjatë kësaj periudhe ka qenë mbështetja e sektorit privat për të lehtësuar ndikimin e pandemisë dhe dëmet që ka shkaktuar tek qytetarët dhe bizneset. Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është konsoliduar Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, për fuqizimin e dialogut publiko privat dhe për të adresuar shqetësimet dhe sfidat me të cilat ky sektor është ballafaquar gjatë këtyre muajve, nëpërmjet caktimit të Sekretariatit brenda ZKM në kuadër të shërbimit civil.
- Janë mbështetur 84 biznese, nëpërmjet përkrahjes financiare të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese (24 biznese përfituese në vlerë totale prej 500 mijë euro),
- Janë mbështetur 18 NVM në sektorin e digjitalizimit, në marrëveshje me ADA-në austriake, në vlerë totale prej 50 mijë euro.
- Janë mbështetur 29 kompani të grave ndërmarrëse, në vlerë totale prej 400 mijë euro dhe janë mbështetur 13 biznese në certifikimin dhe standardizim të kompanive në bashkëpunim me BB-në, në vlerë totale prej 318 mijë e 570 euro.
- Janë miratuar 4 akte nënligjore si në vijim: Udhëzimi Administrativ për Formën dhe Përmbajtjen e Shenjës së Konformitetit dhe Mënyrën e Njohjes së Dokumenteve të Huaja të Konformitetit (17.09.2020), U.A (MTI) nr. 08/2020 për caktimin e kushteve për vendosjen e aggregateve dhe mbushësve për beton në treg (23.10.2020), UA (MTI) nr. 07/2020 për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg (19.08.2020), UA (MTI) nr. 06/2020 për caktimin e kushteve për vendosjen e produkteve për shtrim nga betoni në treg (23.10.2020), Rregullorja (QRK) – Nr. 24/2020 për Grupet e Produkteve të cilat janë Subjekt i Mbikëqyrjes Inspektuese (22.10.2020).
- Është zhvilluar dhe publikuar Platforma për krijimin e Regjistrimit të Rregullave Teknike dhe Trupave të Emëruara për Vlerësimin e Konformitetit.

- Në fushën e inspektimeve, Inspektorati i Tregut ka realizuar 982 inspektime, ku 580 janë të përfunduara, ndërsa 402 lëndë janë në procedurë.
- Është miratuar Rregullorja (QRK) - nr. 24/2020 për grupet e produkteve të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes inspektuese (26.10.2020).
- Është themeluar komisioni ndërministror për investime strategjike. Janë formuar tri grupe operative për vlerësim të tri subjekteve aplikuese për marrjen e statusit të investitorit strategjik.
- Janë duke u bërë investime në katër zona ekonomike (Suharekë, Vushtrri, Lipjan dhe Viti) ku planifikohen të përgatiten rreth 50 hapësira (parcela) për vendosje të bizneseve të huaja dhe vendore. Sa i përket kornizës ligjore, Projektligji për Zona Ekonomike është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
- Në fushën e regjistrimit të bizneseve Qeveria ka miratuar udhëzimin Administrativ nr. 01/2020 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (24.06.2020), Udhëzimi Administrativ nr. 02/2020 për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar të shoqërive tregtare (25.06.2020), Udhëzimi Administrativ për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe ndryshimit të të dhënave të shoqërive tregtare në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (07.07.2020), dhe Udhëzimi Administrativ nr. 14/2020 për çregjistrimin e bizneseve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (16.12.2020).
- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 6 mijë 173 biznese të reja ndërsa janë shuar 841 biznese.
- Në fushën e politikave tregtare, është themeluar Komiteti Nacional për Tregtinë në Shërbime dhe është publikuar për herë të parë vendimi për përfshirjen e Kosovës në listën e vendeve të treta me të drejtë eksporti për produkte ushqimore me origjinë shtazore në vendet e Bashkimit Evropian.
- Është miratuar nisma për miratimin e “Protokollit numër 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përbrenda CEFTA-së” dhe është caktuar ekipi negociues.
- Është miratuar Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 11/2020 për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe prodhimin e tij (13.11.2020) dhe janë lëshuar 5 licenca për tregtimin me duhan.

- Në fushën e tregut të naftës, është miratuar Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 09 /2020 për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës (11.11.2020) dhe janë aprovuar 281 licenca për subjektet afariste për tregti me pakicë me naftë dhe derivate të naftës dhe janë refuzuar 6 kërkesa për licencim.
- Në fushën e pronësisë industriale, është miratuar Udhëzimin administrativ (MTI) nr. 10/2020 për përfaqësues të autorizuar në fushën e pronësisë industriale (13.11.2020) dhe Rregullorja (MTI) nr. 01/2020 e punës për komisionin e ekspertëve për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimorë (25.06.2020).

Sa i përket sigurimit të financave publike të shëndosha, përmes reformave në Menaxhimin e Financave Publike dhe bashkëpunimin me Institucionet Financiare Ndërkombëtare, janë arritur këto rezultate:

- Është arritur që të përmyllen procedurat për nënshkrim të 9 marrëveshjeve në vlerë financimi prej rreth 250 milionë euro, ku 213 milionë euro janë financim për luftën ndaj pandemisë COVID-19. Financimi përfshin rreth 26 milionë euro pajisje mjekësore dhe rreth 30 milionë intervenime në sektorin shëndetësor. Marrëveshjet përfshijnë: Marrëveshjen me Bankën Botërore në vlerë prej 46 milionë euro për “Projektin Emergjent COVID-19 për Kosovën”, ku deri më tani janë disbursuar rreth 28 milionë euro; Asistenca Marko-financiare me Bashkimin Evropian në vlerë prej 100 milionë euro, ku deri më tani janë disbursuar 50 milionë euro dhe pjesa tjetër pritet të disbursohet në fillim të vitit 2021; Marrëveshja me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “Reagimi Emergjent ndaj COVID-19” në vlerë prej 35 milionë euro, ku deri më tani janë disbursuar rreth 17 milionë euro; dhe marrëveshje të tjera të ndërlidhura; Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për “Financimin Emergjent të Infrastrukturës Vitale” në vlerë prej 30 milionë euro; Marrëveshja me Bankën Botërore lidhur me financimin e programit - nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit; Marrëveshja me Bankën Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan.
- Janë nënshkruar tri Marrëveshje Granti ku bëjnë pjesë: 1. Marrëveshja e Amandamentimit për Bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane për Fazën Dalëse VI të Programit Mbështetës për Ujëra dhe Kanalizim në Zonat Rurale; 2. Marrëveshja e Grantit me BERZH për Rrugët

Rajonale - Mbështetje për Njësinë Zbatuese të Projektit; 3. Marrëveshja e Grantit me Bankën Botërore për Financimin e Urgjencës së Pandemisë COVID-19.

- Është nënshkruar Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishhtë me Letoninë dhe Marrëveshja për Amendamentin e METD me Shqipërinë e cila është nënshkruar në Janar të vitit 2015, dhe pritet të nënshkruhen së shpejti Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishhtë me Lituaniën, Portugalinë dhe Italinë.
- Gjatë kësaj periudhe poashtu janë përmbyllur negociata me Qeverinë Gjermane për Bashkëpunim Financiar, ku Qeveria Gjermane ka zotuar mbështetje në vlerë prej 72 milionë euro për projekte të ndryshme në sektorin e energjisë, ambientit, ujërave, mbështetje për sektorin privat, etj.
- Përmes marrëveshjes me BQK dhe BKS, Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër mbulimin e plotë të primit të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët dhe palët që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë gjatë vitit 2020.
- Si rezultat i zbatimit të Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), në korrik 2020 nga BE janë transferuar në Thesarin e Kosovës në emër të progresit në zbatimin e Indikatorëve Variabil në MFP gjithsej 6 milion e 875 mijë e Euro. Kërkesa për rishikim të indikatorëve variabil për vitin 2020 si dhe kërkesa për transhe fikse shtesë janë aprovuar nga Komisioni Evropian. Në dhjetor 2020 është bërë transferi i transhes fikse shtesë prej 3.125.000 euro. Deri më sot, në Thesar janë transferuar gjithsejtë 16 milion euro të SBS në MFP (nga totali prej 21 milion euro).
- Gjatë periudhës raportuese është finalizuar Marrëveshja për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale (SBS) nga fondet IPA 2019 – *“EU4 Resilience – Kosovo” në mes të Kosovës dhe BE-së*, për lehtësimin e pasojave të pandemisë së Covid-19. Marrëveshja kap shumën prej 26.5 milion euro. Në nëntor 2020 është përgatitur dhe dërguar kërkesa për transferim të transhes fikse për vitin 2020, në shumë prej 20.5 milion euro. Pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve për transhën fikse, në dhjetor 2020 janë transferuar në Thesarin e Kosovës 20.5 milion euro. Transha variabile prej 6 milion euro, pritet të transferohet në Thesar në vitin 2021.

Në kuadër të politikave makro-fiskale janë ndërmarrë këto masa:

- Është publikuar Buletini Makroekonomik, që ofron një pasqyrë ekonomike për tremujorin e parë të vitit 2020.

- Është përgatitur Programi i Reformave në Ekonomi 2021-2023, që në fokus do të ketë rimëkëmbjen ekonomike në Kosovë pas krizës të shkaktuar nga pandemia COVID-19.
- Është përfunduar Analiza lidhur me Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike COVID 19, Analiza për kalendarin e akcizës në duhan dhe Mbledhjen e të dhënave nga ATK-ja dhe Dogana, si dhe zhvillimi i modelit ekonometrik për Analizën e Kostove dhe Benefiteve lidhur me Lirimet e Prodhuesve.
- Është miratuar Udhëzuesi për zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit gjatë periudhës COVID-19 nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF-K), në konsultim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
- Në fushën e doganave, janë mbledhur të hyrat në vlerë 1 miliard e 13 milion e 265 mijë e 138 euro e 85 cent. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që kishim të hyra prej 1 miliard e 131 milion e 658 mijë e 493 euro e 98 cent, këtë vit janë realizuar të hyra më pak për – 10 %.
- Meqenëse, efekti i pandemisë COVID 19 përgjatë vitit 2020 ka ndikuar në mënyre direkte në rënien e mbledhjes së të hyrave, shuma e inkasuar nga borxhet është 2 milion e 96 mijë e 460 euro e 62 cent, pa përfshirë shumën e garancive bankare të inkasuara për këtë periudhë. Shuma e mjeteve të inakuara për garanci bankare është në vlerën prej 1 milion e 116 mijë e 524 euro e 59 cent, e cila shumë në momentin e shkarkimit të DUD-ave (borxhi i deklaratave të mbuluara me GB), do të zbritet nga borxhet tek deklaratat.
- Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përcaktimin e mesatareve të importit për të gjitha subjektet importuese ashtu siç parashihet sipas nenit 241 të Kodit Doganor dhe Akcizës dhe prej datës 01.09.2020 ka filluar aplikimi i normës së akcizës sipas vendimit të bashkangjitur, 48€ për njësi konvencionale.
- Në kanalën e kuq për kontrollë fizike (IM4, IM5, IM6, IM7, IM9) janë përzgjedhur 19.03% e deklaratave, ndërsa në kanalën e verdhë për kontroll dokumentare janë 55.54% e deklaratave. Metoda e vlerësimit të mallrave, sa i përket pjesëmarrjes së vlerës së mallrave, është aplikuar metoda e parë e vlerësimit prej 97.64% dhe metoda e gjashtë e vlerësimit prej 2.35%.
- Janë ndërmarrë veprime me qëllim të lehtësimit të uljes së kontrollit të eksportit të rregullt: 88.01% të dërgesave kanë përfunduar procedurën e eksportit prej 0 - 30min, ndërsa 4.08%

prej 30-60 min. Që do të thotë se brenda 60 minutave kanë përfunduar rreth 92.09% të deklaratave të eksportit.

- Janë realizuar 2 mijë e 555 patrullime në vijën e gjelbër dhe në pjesë të brendshme të territorit, ku janë zbuluar 287 kundërvajtje, janë iniciuar 46 raste, janë bërë 47 kallëzime penale për 15 persona; janë vërejtur 2 milion e 362 mijë e 288 euro shmangie të identifikuar; 1 person është arrestuar; 367 mijë e 646 euro dhe me efekt fiskal prej 1 milion e 685 mijë e 596 euro janë sekuestruar; janë aprovuar 64 kërkesa për veprim doganor për 277 marka tregtare; 107 raste, 233 mijë e 445 njësi me 274 mijë e 691 euro të mallrave që shkelin DPI-në janë konfiskuar; janë iniciuar për verifikim të origjinalitetit 277 raste të kundërvajtjeve doganore në vlerë prej 233 mijë e 445 euro dhe janë iniciuar 408 mijë e 351 euro gjoba të inkasuara.
- Janë ndërmarr në vazhdimësi veprime në luftimin e korrupsionit nëpërmjet ndërmarrjeve dhe veprimeve preventive: 20 inspektime të realizuara, 14 raste të përfunduara, 4 raste që rezultojnë me zbulim të shkeljeve disiplinore, përkatësisht me 14 raste të pranuar, 20 zyrtarë të raportuar dhe 44 formular të deklaramit pasuror të pranuar
- Është ratifikuar marrëveshja me Komisionin Evropian për Programin “Customs 2020” dhe është bërë pagesa e anëtarësimit në Organizatën Botërore të Doganave.
- Në fushën e tatimeve, janë realizuar të hyra tatimore në shumën prej 258 milion e 465 mijë e 437 euro e 48 cent.
- Janë bërë 648 kontrole, ku si rezultat tatimi shtesë është 26 milion e 082 mijë e 503 euro e 66 cent, kreditimi është zbritur për 4 milion e 590 mijë e 845 euro e 23 cent, ndërsa humbja është zbritur për 21 milion e 673 mijë e 670 euro e 57 cent.
- Sa i përket vizitave, gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjithsej 5 mijë e 369 vizita, ku si rezultat janë në qarkullim shtesë në shumën prej 43 milion e 129 mijë e 869 euro e 52 cent, tatim shtesë është 2 milion e 908 mijë e 184 euro e 68 cent, ulja e kreditimit është 1 milion e 317 mijë e 574 euro e 45 cent si dhe zvogëlimi i humbjes ishte 3 milion e 232 mijë e 115 euro e 65 cent.
- Shuma e borxheve tatimore të krijuara është 41 milion e 796 mijë e 696 euro e 25 cent, ndërsa janë inkasuar 44 milion e 251 mijë e 5 euro borxhe tatimore.

- Lidhur me rimbursime, numri i kërkesave nga tatimpaguesit që kanë kërkuar rimbursim është 977, shuma e kërkuar është 25 milion e 644 mijë e 616 euro e 40 cent, ndërsa shuma e aprovuar është 21 milion e 588 mijë e 7 euro e 56 cent.
- Është ratifikuar marrëveshja ndërmjet BE-së dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e BE-së “Fiskalis 2020”.
- Është bërë vlerësimi i përgjithshëm i Pronave Komerciale dhe Industriale për qëllime të tatimit në pronë në të gjitha komunat.
- Janë inkasuar 14.4 milion Euro nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë gjatë kësaj periudhe kanë shënuar një rënie prej 13 % apo 2.2 milion euro më pak në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.
- Në fushën e përkrahjes së komunave dhe sektorit privat (bizneseve), MZHR-ja ka lansuar dy programe: Programin për Zhvillim Rajonal, i cili ka për qëllim përkrahjen e komunave për përmirësimin e infrastrukturës publike dhe Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, i cili zbatohet me qëllim të përkrahjes së bizneseve kryesisht prodhuese, me premisa të zgjerimit të kapaciteteve të tyre dhe me synime të zëvendësimit të importit.
- Në zbatim të Programit për Zhvillim Rajonal (kategoria e investimeve kapitale) për vitin 2020, janë nënshkruar 30 Marrëveshje të mirëkuptimit me 26 komuna për përkrahje të projekteve të investimeve kapitale në vlerë prej rreth 2.5 mil €.
- Në zbatim të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (Përkrahja e bizneseve PZHRB 2020): janë mbështetur 155 biznese. në shumë prej 2.4 milion.
- Në zbatim të Programin për Rimëkëmbje Ekonomike 2020, Masës 8, janë mbështetur 168 biznese, në vlerë prej 2 milion euro.
- Në zbatim të Programit për përkrahjen e OSHC-ve, janë mbështetur 21 projekte/OSHC.
- Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe vendor, janë nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi, me BERZH-in, UNICEF-in dhe Odën Ekonomike të Kosovës.

Duke marr parasysh se gjendja e krijuar nga pandemia COVID 19 ka ndikuar gjithashtu në performancën dhe të ardhurat e ndërmarrjeve publike, Qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa konkrete për të mbështetur këto ndërmarrje:

- Janë aprovuar kriteret për mbështetjen e Ndërmarrjeve Publike për zbatimin e masave që dalin nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Në kuadër të këtyre masave hyn mbështetja për këto ndërmarrje: NP Trepça sh.a. mbështetet në vlerën totale pre 100 mijë euro si

pasojë e vështirësive financiare të rënies së çmimeve në bursë, që ka ndikuar në uljen e të hyrave dhe shitjes; KRU Mitrovica sh.a. është mbështetur në vlerën prej 200 mijë euro, për shkak se është prekur nga pandemia COVID 19 dhe vështirësive financiare të krijuara; KRU Hidromorava sh.a. është mbështetur me 300 mijë euro për të evituar vështirësitë financiare si pasojë e gjendjes emergjente shëndetësore; KRM Çabrati është mbështetur me 400 mijë euro me qëllim të bartjes së mbeturinave nga deponia e përkohshme (Stacioni i Transferit) në deponinë e Landovicës, e cila ka për qëllim edhe mbrojtjen e ambientit.

- Ka vazhduar aktiviteti për mbështetjen e NP Trepça Sh. A. për realizimin e projekteve: Hapja e vend punishteve të reja në horizontet X-XI Miniera) "TREPÇA" Stanterg, ku janë transferuar mjete financiare në bazë të kërkesës së NP Trepça Sh. A. në vlerë prej 548 mijë e 993 euro e 62 cent.
- Hapja dhe përgatitja e Trupit Xeherorë ndërmjet Horizonteve IV-V-VI) në vlerë prej 200 mijë euro.
- Instalimi i pajisjeve filtruese për përmirësimin e teknologjisë dhe kushteve të punës-Fabrika për konservimin e mbeturinave akumuluese – Zveçan LOT 1-ndërtimi i Impianteve një vakum të ri filtrues me automatizimin e plotë në flotacion, kompresor i furnizimit dhe makineri të transportit të mallrave, punës dhe pajisjet – Zveçan) në vlerë 135 mijë e 700 euro, për këtë periudhë raportuese.
- Programi Mbështetës për Ujësjellës & Kanalizime në Zonat Rurale - Faza VI-të (RËSSP-VI)" e financuar nga Qeveria Zvicerane (SDC) dhe Qeveria e Kosovës (projekt në vazhdim) për vitin 2020 në ligjin e buxhetit janë alokuar mjete financiare në vlerë prej 3 milion euro. Për këtë periudhë raportuese CDI ka bërë kërkesë për transferim të mjeteve financiare në vlerë prej 3 milion euro. Mjetet e buxhetuara për vitin 2020 janë transferuar në tërësi për realizimin e projektit.
- Për rritje të cilësisë së shërbimit, Ndërmarrja Publike Trainkos ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve në vlerë prej 97 mijë e 211 euro e 76 cent, e cila është ekzekutuar.
- Ndërmarrja Publike “Ngrohtorja e Gjakovës” ka bërë kërkesë për transferim të mjeteve financiare në vlerë prej 400 mijë euro, subvencion për lëndë djegëse mazut, mjete të cilat janë transferuar në tërësi.

- Ndërmarrja Publike e ujit dhe mbeturinave kanë bërë kërkesë për transferim të mjeteve financiare në kategorinë e shpenzimeve subvencion dhe transfere në vlerë prej 650 mijë euro, për këtë periudhë raportuese.

Në kuadër të arritjes së objektivës “Zhvillimi i Teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK)” janë realizuar aktivitete e mëposhtme:

- Projektligji për Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike, është miratuar nga Qeveria,
- Projektligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, është miratuar nga Qeveria më datë 30.10.2020 dhe tani është në procedura të aprovimit në Kuvend;
- Hartimi i draftit të Projektligjit për masat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit është duke vijuar. Sipas planifikimeve projektligji duhet të miratohet në Qeveri deri në gjysmë të vitit 2021.
- Udhëzimi Administrativ për Pullë Postare është miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit më datë 11.08.2020;
- Projekti i Krijimit të Qendrës për Ekselencë Dixhitale në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, është në fazat e fundit të implementimit.
- Projekti Shtrirja e Infrastrukturës brezgjere në zona të pambuluara përmes programit KODE, është realizuar me sukses të plotë. Gjatë muajve shkurt deri në gusht janë publikuar gjashtë Thirrje për Aplikim sipas skemës së granteve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale. Nga këto thirrje janë nënshkruar gjithsejtë 21 Marrëveshjeve për Grante, të cilat kanë përfunduar zbatimin gjatë pjesës së dytë të vitit, deri në gjysmë të dhjetorit 2020. Gjithsej nga këto Thirrje janë mbuluar 62 fshatra me infrastrukturë fikse brezgjere dhe po ashtu janë lidhur 36 institucione publike (27 shkolla, 9 ambulanca) në këto zona me internet falas për së paku 5 vite.
- Projekti i krijimit të Rrjetit Kombëtar për Huluntim dhe Edukim në ITP Prizren, që përfshin krijimin e një qendre të të dhënave dhe lidhjen e institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës, është në fazën para nënshkrimit të kontratës. Ndërtimi i Rrjetit Kombëtar për Huluntim dhe Edukim, dhe lidhja me rrjetin pan-evropian GÉANT do të mundësoj

shfrytëzimin e shumë shërbimeve dhe resurseve shkencore për institucionet e arsimit të lartë të Kosovës (Universitetet, Kolegjet, etj.).

- Projekti, krijimi i Stacionit Fiks për Monitorimin e Frekuencave, është nën-komponentë e Projektit KODE për të cilin projekt kanë përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit dhe më datë 18.12.2020 është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik zbatues.
- Më 2 Nëntor 2020 në kuadër të Samitit Dixhital të Ballkanit Perëndimor janë nënshkruar dy memorandume në mes të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor: Memorandum i Mirëkuptimit për Udhërrëfyesin 5G për Transformimin Dixhital në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Memorandum i Mirëkuptimit për Interoperabilitetin dhe Shërbimet e Besimit Rajonal në Rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Ka përfunduar pjesa e 3-të e projektit "Renovimi i Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi në UP".

4. Drejtësi e pavarur dhe efikase

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, Agjendës për Reforma Evropiane, Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ka ndërmarrë masa në sektorin e drejtësisë për avancimin dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë dhe rritjen e llogaridhënies së tyre, përmirësimin e zbatimit të legjislacionit, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe terrorizmit, bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë, forcimin e shërbimit sprovues të Kosovës, Instituti e Mjekësisë Ligjore dhe Avokaturën Shtetërore.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është hartuar Strategjia e Drejtësisë, e cila është dërguar në konsultim publik. Strategjia parasheh masa konkrete për përmirësimin e sektorit të drejtësisë, që ndikojnë në forcimin e pavarësisë, integritetit, transparencës së institucioneve të zbatimit të ligjit dhe që ndikojnë në kohën, koston, zvogëlimin e burokracisë së panevojshme dhe zbatimin më të mirë të legjislacionit në institucione të zbatimit të ligjit.
- Është hartuar projektligji për Gjykatën Komerciale, e cila do të shqyrtojë dhe vendos për kontestet juridike lidhur me çështjet ekonomike dhe konfliktet administrative, që do të zvogëlojë kohën dhe koston e zgjidhjeve të këtyre rasteve, për bizneset dhe qytetarët.

- Është hartuar projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, që synon të përcaktoj ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, dhe aplikimin e masës së paraburgimit, dhe i njëjti do të zbatohet për ekzekutimin e sanksioneve penale të shqiptuara nga gjykatat vendore dhe të huaja.
- Është hartuar projektligji për Shërbimin Korrektues, që ka për qëllim përcaktimin e statusit, parimet, përgjegjësitë, menaxhimi dhe organizimi i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim, të drejtat ose detyrimet specifike, rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave, zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime, transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- Është hartuar projektligji për Shërbimin Sprovues - ka për qëllim që të përcaktoj statusin, parimet dhe organizimin e përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës, me qëllim të rehabilitimit dhe ri -integritetit shoqëror të personave nën mbikëqyrje, gjithashtu, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik.
- Është hartuar projektligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që ka për qëllim evitimin e të metave dhe problemeve të hasura në praktikë lidhur me zhvillimin e procedurës disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, përkatësisht, lidhur me shqiptimin e suspendimit për gjyqtarë dhe prokurorë. Drafti i ka kaluar fazat e konsultimeve, i kemi marre deklaratat përkatëse dhe se shpejti do të procedohet për miratim në Qeveri.
- Është hartuar projektkodi i procedurës penale, që synon eliminimin e të gjitha mangësive, zbrazëtirave dhe vështirësive të evidentuara gjatë zbatimit të Kodit aktual nga ana e institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, duke filluar nga Policia e Kosovës e sidomos nga ana e Gjykatave dhe Prokurorive të Republikës së Kosovës.
- Është hartuar projektligji për Provimin e Jurisprudencës, që synon eliminimin e pengesave gjatë provimit të Jurisprudencës.
- Është hartuar projektligjin për Avokaturën Shtetërore, që ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e funksionimit të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfaqësimit sa më efikas dhe transparent në procedurat gjyqësore, administrative dhe të arbitrazhit.

- Është miratuar Projekt Kodi Civil nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili mes tjerash, synon që të bëjë rregullimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore të së drejtës civile.
- Janë miratuar tri ligje esenciale në fushën e të drejtave pronësore: Projektligji për Tokën Ndërtimore, Projektligji për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj, dhe Projektligji për Pronën Publike.
- Është hartuar projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK), nëpërmjet të cilit ndryshohet statusi i Agjencisë dhe orientimi i saj si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit si dhe është bërë qartësimi i përgjegjësive të AKK-së.
- Është hartuar Rregullorja për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, qëllimi i të cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës.
- Është hartuar projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, që përcakton parimet, kompetencat, rendin dhe procedurat për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet civile ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve të huaja.
- Është miratuar projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale, me qëllim të eliminimit të mangësive që çojnë në probleme substanciale dhe të joefikasitetit lidhur me procedurat e ekstradimit, transferimit të personave të dënuar dhe ndihmës juridike të ndërsjellë.
- Është miratuar projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për transferimin e personave të dënuar, i cili ka për qëllim eliminimin e të gjitha mangësive, zbrazëtirave të evidentuara nga ana e institucioneve përgjegjëse në fushën e transferimit të personave të dënuar.
- Është miratuar projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private, që përmban rregulla për caktimin e të drejtës kompetente tek marrëdhëniet juridiko-private me element ndërkombëtar, rregulla për kompetencën e gjykatave dhe organeve tjera për shqyrtimin e atyre marrëdhënieve dhe rregulla për procedurën, si dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shteteve të huaja.
- Është finalizuar Marrëveshja me Republikën e Shqipërisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Civile dhe Tregtare dhe Marrëveshja për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike

në Çështje Civile me Maqedoninë e Veriut. Qëllimi i këtyre Marrëveshjeve është forcimi i mëturshëm i bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike në çështjet civile dhe tregtare në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe lehtësimi i procedurave ligjore mes tyre në këtë fushë.

- Është krijuar grupi punues për procesin e vettingut që ka për qëllim hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për reformën në sistemin e drejtësisë, të cilat presin shqyrtimin përfundimtar në Qeveri.
- Është miratuar Koncept Dokumenti për kompensimin e viktimave të krimit, nëpërmjet të cilit është bërë analizë e thukët mbi programin dhe kornizën legjislative aktuale në Kosovë që rregullon këtë fushë.
- Është hartuar Koncept Dokumenti ‘Magnitsky’ - Legjislacioni ‘Magnistky’ i referohet ligjeve të cilat vendosin sanksione të shënjestruara për shtetasit e huaj të përfshirë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe ata të përfshirë në veprat serioze të korrupsionit që rezultojnë në abuzim të të drejtave të njeriut.
- Është realizuar vlerësimi ex-post i Ligjit nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit.
- Është hartuar Udhëzimi Administrativ Nr. 02/20201 për Mbrojtjen Juridike të personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara.
- Është hartuar Udhëzim Administrativ Nr.03/20201 për Mbështetjen e Nevojshme Financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, për shpenzimet e ndërlidhura me udhëtimet e tyre kur procedurat gjyqësore zhvillohen jashtë Kosovës.
- Është hartuar Udhëzimi Administrativ Nr. 04/20201 për Kompensimin e Personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, të shpallur të pafajshëm me vendim të plotfuqishëm.
- Është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Rrjetin e Grave të Kosovës dhe Rrjetin e Shitësve me Pakicë. Memorandumi ka për qëllim lehtësimin e qasjes në punësim të personave të strehuar në strehimoret e dhunës në familje dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.
- Është arritur funksionalizimi si pilot projekt i Qendrës për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve, Njësisë së Inteligjencës dhe Njësisë Ekonomike në kuadër të Shërbimit

Korrektues të Kosovës, si dhe janë miratuar tri Udhëzime Administrative nga Ministria e Drejtësisë: Udhëzimi administrativ për ndalimin e vizitave për shkaqe të justifikueshme; Udhëzimi administrativ për pushimin e të Miturve jashtë Institucionit Korrektues si dhe Udhëzimin administrativ për programin, të drejtat, obligimet dhe beneficionet për të Mitur në Qendrën Edukativo Korrektuese.

- Në kuadër të profesioneve të lira, është hartuar drafti i Udhëzimit Administrativ për tarifën për Noter, ku përcaktohen tarifën e punës së noterëve, si dhe Udhëzimi Administrativ për tarifën për ndërmjetësues.
- Është miratuar Rregullorja Nr. 01/20201 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, me qëllim të funksionalizimit të plotë të Institutit për Mjekësi Ligjore.
- Në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës, është hartuar Programi për Ekzekutimin e masave të Diversitetit, si dhe është hartuar Doracaku i Punës për zbatimin e plotë të masave të Programit. Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të SHSK-së për mbikëqyrjen e Masave dhe Dënimeve Alternative (MDA)-së, gjatë periudhës raportuese, janë hartuar materialet trajnuese për nevojat e zyrtarëve të cilat mëtojnë zbatim sa më të mirë të masave së diversitetit dhe dënimeve.

5. Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, si dhe përmirësimit të raporteve me partnerët strategjik, ka marrë masa konkrete për normalizimin e marrëdhënieve me SHBA-të, vendet kryesore të BE-së, liberalizimin e vizave, fondet e BE-së dhe koordinimin e donatorëve.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Politika e jashtme e Kosovës ka qenë në funksion të ndërtimit, ruajtjes e thellimit të marrëdhënieve me partnerët strategjikë dhe me shtetet e tjera.
- Është kryesuar takimi i ministrave të Punëve të Jashtme të SEECP, si dhe ka marrë pjesë në aktivitetin përmbyllës të kryesimit të Republikës së Kosovës të Presidencës së MARRI. Gjithashtu, ka marrë pjesë në Sesionin e 110-të të Këshillit Permanent të Frankofonisë.
- Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe zhvillimit të marrëdhënieve me ShBA-të nëpërmjet takimeve si me bartës të titujve shtetëror ashtu dhe me përfaqësues së komunitetit Kosovar në ShBA. Këto përfshihen: Takimi me anëtarin e Këshillit të Bashkësisë së Nju Jorkut z. Mark Gjonaj; Takim me zv. Presidentin e “Heritage Foundation” z. James Carafano në Uashington; Takim me zv. Ndhmës Sekretarin Amerikan z. Mattheë Palmer në Uashington; Takim me Drejtorin e Lartë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe znj. Amanda B.Ahlers -Drejtoreshë për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve; dhe Takim me Ndhmës Sekretaren për Çështje të Arsimit dhe Kulturës në Departamentin e Shtetit znj. Marie Royce.
- Zhvillime të shumta gjatë kësaj periudhe ka pas edhe në iniciimin e procedurave për lidhjen e Marrëveshjeve Ndërkombëtare. Disa që vlejné të cekën janë: Pëlqimi për nënshkrimin e Memorandumit RKS -Dukati i Madh i Luksemburgut; Pëlqimi për nënshkrimin e Memorandumit në mes të MSH dhe QATAR Charity; Autorizim për delegim të kompetencës tek z. Ilir Dugolli, Ambasador i Republikës së Kosovës në Ankara, për nënshkrimin e Marrëveshjes për "Donacion në fushën e shëndetësisë" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë; Draft-Autorizim për nënshkrimin e Marrëveshjes për "Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë sa i përket tatimit në të ardhura dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies" në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Mbretërisë së

Holandës; Pëlqim për nënshkrimin e Marrëveshjes lidhur me projektin Shëndetësia e qasshme dhe cilësore (ShQC) Faza II, ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Konfederatës Zvicerane përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si marrëveshje ndërinstitucionale; Autorizim për Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Portugali, për nënshkrimin e Marrëveshjes për "Eliminim të Tatimit të Dyfishtë në mes të Kosovës dhe Portugalisë"; ndër të tjera.

- Është hartuar projektligji i ri për shërbimin e jashtëm dhe projektligji për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare, të shënjestruara.
- Pas gati dy vitesh, ka rifilluar procesi i dialogut me Serbinë. Ky nuk është dialog teknik, por dialog për marrëveshje finale për njohje reciproke dhe normalizim të raporteve në mes të dy vendeve. Ky proces i dialogut për marrëveshje për njohje reciproke ka nisur më datë 10 korrik, kur nën organizimin e Presidentit të Francës, Emanuel Macron, dhe Kancelarës së Gjermanisë, Angela Merkel, është mbajtur Samiti i Parisit. Të dy palët kanë prezantuar qëndrimet e tyre. Ndërkaq, nga organizatorët e samitit janë dhënë mesazhet e qarta se dialogu është i kufizuar në kohë dhe është për marrëveshje përfundimtare për normalizim të plotë të marrëdhënieve, që nënkupton njohje reciproke. Bazuar në këto qëndrime të qarta, u mbajt video konferenca e parë në mes të dy palëve më 12 korrik 2020. Ndërkaq, më 16 korrik dhe 7 shtator janë mbajtur takimet e nivelit të lartë në Bruksel. Në mes të këtyre datave janë mbajtur disa takime të koordinatorëve të dialogut. Qasja serioze e Qeverisë së Kosovës në këtë proces ka ndikuar që SHBA-të të angazhohen fuqishëm dhe të marrin rol aktiv. Në këtë funksion, më 3 dhe 4 shtator, Qeveria e Kosovës është ftuar në Shtëpinë e Bardhë për të dialoguar për normalizim të marrëdhënieve ekonomike. Këto biseda kulmuan më 4 shtator, ku në prani të Presidentit Trump, u nënshkrua marrëveshja e zotimit për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis dy shteteve. Kjo marrëveshje në përmbajtjen e saj i ka 16 pika, të cilat përfshinë: projekte të mëdha infrastrukturore, funksionalizimi i pikës kufitare në Merdar, gatishmëria për hyrje në zonën minishengen, njohja e diplomave dhe certifikatave, studimi i fizibilitetit nga Departamenti për Energji i SHBA-së për përdorimin e ujit të liqenit të Ujmanit, njohja reciproke me shtetin e Izraelit, si dhe pika të tjera. Njohja nga shteti i Izraelit paraqet një fitore të madhe diplomatike të Kosovës. Kjo njohje e ka thyer bllokadën disa vjeçare të mungesës së njohjeve të reja për

Kosovën. Kjo njohje e ka ndërruar trajektoren për fuqizimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtarë.

- Është përfunduar procesi i riorganizimit të strukturave të ish-Ministrisë së Integritetit Evropian, pas shuarjes së saj nga Qeveria, ku janë bartur në ZKM të gjitha funksionet e ish-MIE-së.
- Është miratuar dhe lansuar ERA, e cila përmban 15 prioritete, të ndara në tri shtylla: Shtylla 1: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit – 4 prioritete; Shtylla 2: Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm – 6 prioritete; dhe Shtylla 3: Punësimi, arsimi dhe shëndetësia – 5 prioritete.
- Është miratuar Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA, që përmban gjithsej 193 masa: 107 masa legjislative dhe 86 masa zbatuese.
- Sa i përket liberalizimi të vizave, për zgjidhjen e rasteve të shënjestruara të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, nga janari 2020 janë 69 raste, përfshirë 7 raste shtesë të shënjestruara deri në tetor 2020. Nga 69 raste të shënjestruara, 43 janë raste të korrupsionit (me 290 persona të akuzuar) dhe 26 janë raste të krimit të organizuar (me 238 persona të akuzuar). Janë ngritur 59 aktakuza, prej tyre 10 gjatë këtij viti. Nga 59 aktakuza, 34 janë raste të korrupsionit (me 239 persona të akuzuar) dhe 25 janë raste të krimit të organizuar (me 214 persona të akuzuar). Gjendja me rastet përgjatë fazave të ndryshme është si në vijim: 23 raste janë mbyllur; për 19 raste janë nxjerrë vendime gjyqësore të formës së prerë; në 3 raste janë nxjerrë vendime për pushimin e hetimeve; dhe për 1 rast janë pezulluar hetimet; për 1 rast prokuroria ka hedhur poshtë aktakuzën për shkak të vdekjes së të akuzuarit; 36 raste janë në procedurë gjyqësore, prej të cilave: për 8 raste janë nxjerrë aktgjykime nga gjykatat themelore; 28 raste janë në gjykim sipër, dhe 6 raste janë në fazën e hetimeve.
- Janë nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha Marrëveshjet Financiare nga IPA II, përveç marrëveshjes financiare për IPA 2020, e cila është miratuar nga Qeveria dhe dorëzuar në Kuvend për ratifikim.
- Janë finalizuar kërkesat për disbursimin e mbështetjes buxhetore sipas kontratës sektoriale për reformën e administratës publike, kërkesat për disbursimin e kësteve të kontratës sektoriale për menaxhimin e financave publike dhe asaj për rimëkëmbje dhe janë dorëzuar tek BE-ja me ç'rast janë përfituar 24 milionë euro nga BE-ja në buxhetin e vendit.

6. Arsimi dhe shkenca

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të programit të saj, ka ndërmarrë masa në sektorin e arsimit për realizimin e mësimit online, infrastrukturën arsimore, tekstet dhe mjetet shkollore, arsimit të komuniteteve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për vitin shkollor/ akademik 2020/2021, për përballje me sfidat dhe problemet që kanë lindur si rezultat i pandemisë dhe është miratuar Master Plani për fillimin e vitit të ri shkollor, që ka tre skenarë për realizimin e procesit mësimor në të gjithat nivelet e arsimit parauniversitar (duke përfshirë edhe arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta).
- Janë hartuar planet mësimore, ditore e javore për të gjitha lëndët e përfshira në e-Mësimi për klasat 1-9 për tërë vitin shkollor 2020-2021, si dhe është bërë përzgjedhja e mësimdhënësve dhe e redaktorëve për realizimin e video materialeve, për klasat 1-9.
- Janë hartuar tetë udhëzues dhe protokolle për organizimin e mësimit gjatë vitit shkollor 2020-2021, janë siguruar tekstet mësimore falas për 2 mijë e 900 nxënës të mësimi plotësues në diasporë, si dhe janë organizuar xhirimet e njësisve mësimore në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake, të cilat transmetohen në televizionin publik të Kosovës dhe në kanalin e MASH në Youtube.
- Janë dezinfektuar të gjitha shkollat dhe janë vendosur udhëzimet se si të sillemi në shkollë në kushte pandemie. IKSHPK-ja ka realizuar edhe trajnimin e drejtorëve komunal, inspektorëve sanitarë, inspektorëve të arsimit dhe drejtorëve të shkollave për masat anti-COVID dhe ato higjienike.
- Janë hartuar projektligji për Tekstet dhe Mjetet Shkollore, Lektyrën Shkollore dhe Dokumentacionin Pedagogjik, projektligji për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), projektligji për Ratifikimin e Plotësimit dhe Ndryshimit të Marrëveshjes së Programit Fulbright, projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe projektligji për Agjencinë Kosovare të Akreditimit.
- Është lansuar platforma online “Edukimi në distancë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme”, e cila ofrohet edhe në gjuhët serbe, turke dhe rome, si dhe nga

muaji tetor transmetohet edhe në RTK, që shërben për edukimin e fëmijëve në moshën e hershme.

- Janë trajnuar 1 mijë e 543 edukatorë për institucionet parashkollore dhe klasën parafillore, si dhe është hartuar “Protokolli për masat lehtësuese për fillimin e punës së institucioneve parashkollore në Kosovë”. Po ashtu, janë rilicencuar 54 kopshte private dhe licencuar për herë të parë 26 syresh. Janë ndihmuar 7 mijë e 823 fëmijë, kryesisht nga komunitetet dhe familjet me asistencë sociale me pako didaktike dhe material higjienik.
- Në përkrahje të fëmijëve me nevoja të veçanta është bërë popullimi i platformës: arsimigjithëpërfshirës.net me aktivitetet mësimore dhe materiale didaktike, si dhe është finalizuar pakoja me dokumentet për vlerësimin pedagogjik; janë hartuar Udhëzuesit për përkrahjen e nxënësve të kësaj kategorie dhe për organizimin e mësimin në qendra burimore për vitin shkollor 2020/2021.
- Sa i përket arsimit të komuniteteve është bërë rishikimi i programeve mësimore për lëndën “Gjuhë shqipe dhe letërsi” për nxënësit e komuniteteve jo shqiptarë si dhe janë përkthyer të gjitha programet mësimore/ lëndore (me përjashtim të lëndëve nacionale) nga gjuha shqipe në gjuhët boshnjake dhe turke, si dhe janë ndarë 596 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkanli dhe egjiptian dhe për studentët e komuniteteve për vitin akademik 2020/2021 sipas konkursit të MASH për studentë të dalluar.
- Është nënshkruar Marrëveshja për Shkëmbim të Materialeve dhe Përvojave me Shqipërinë dhe me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut; janë aprovuar edhe 13 Standarde Kombëtare të Profesionit.
- Është krijuar Barometri i Tregut të Punës që mundëson komunikimin strategjik dhe ndërveprimin e bazave të të dhënave të 10 institucioneve që do të ndihmoj në hartimin e politikave të bazuara në prova për planifikimin dhe zhvillimin strategjik.
- Është funksionalizuar Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe mekanizmat përkatës në kuadër të këtij Këshilli.
- Janë hapur Zyrat për Orientim në Karrierë nëpër disa shkolla të AAP-së;
- Janë përfunduar të gjitha procedurat e harmonizimit sipas legjislacionit në fuqi të statuteve të përhershme për katër universitete publike dhe janë miratuar 52 standarde të reja për gradën e Doktoraturës.

- Është hartuar koncepti i dokumentit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për të rritur cilësinë e arsimit të lartë.
- Janë arritur marrëveshje për fushën e arsimit të lartë me Qeverinë e Francës, Hungarisë, Austrisë; pastaj bashkëpunimi me Ambasadën Amerikane lidhur me Programin Fullbright;
- Është rritur bashkëpunimi me Qeverinë Japoneze për bursa për Bachelor, Master, dhe PhD, si dhe është rritur bashkëpunimi me Universitetin e Sheffieldit nga Mbretëria e Bashkuar.
- Është nënshkruar shkresa “Shprehje e interesit” për avancimin e statusit të Kosovës, në kuadër të programit Kornizë të BE-së për hulumtim dhe Inovacion ‘Horizon 2020’.

7. Shëndetësia

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të programit të saj, ka ndërmarrë masa në sektorin e shëndetësisë, ku pothuajse i tërë angazhimi në këtë sektor është fokusuar në luftimin e pandemisë COVID-19. Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Me qëllim të krijimit të kushteve për fillimin e sigurimeve shëndetësore është finalizuar hartimi i projektligjit për sigurime shëndetësore dhe po ashtu me qëllim të mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës së fondit është themeluar Bordi i ri i fondit të sigurimit shëndetësor.
- Me qëllim të ngritjes së llogaridhënës dhe menaxhimit më të mirë Ministria e Shëndetësisë ka emëruar dhe funksionalizuar mekanizmat mbikëqyrës dhe vendim-marrës sikurse komitetin për menaxhimin e lartë të Projektit të Shëndetësisë Kosovare (përbërja e re ka themeluar komitetin drejtues për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit “Ndërtimi i Spitalit Pediatrik Kirurgjik” në QKUK dhe njësi zbatuese e saj, ka themeluar bordet për shkollim specialistik, bordin për programin e trajtimit jashtë institucioneve shëndetësore publike, bordin për licencimin e institucioneve private shëndetësore dhe komisionin për shqyrtimin e ankesave;
- Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse është miratuar koncepti i dokumentit për sëmundjet ngjitëse, i cili i ka hapur rrugë plotësimit dhe ndryshimit të ligjit për sëmundjet ngjitëse.
- Ministria e Shëndetësisë ka shpallur dhe realizuar me sukses konkursin për 1 mijë e 500 specializantë, duke përfshirë këtu edhe rreth 70 vende për kuadrin nga Lugina e Preshevës. Specializantët kanë filluar në grupe të nënshkruajnë kontratat që nga 9 nëntori dhe janë në nënshkrim e sipër edhe grupet e fundit, derisa të rekrutuarit përmes PSHK/BB kanë filluar punën në mes të tetorit.
- Me synimin për të mos lënë asnjë specialist apo mjek të papunë në Kosovë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, ka hapur konkurs për rreth 150 specialist të papunë për lëmi të ndryshme mjekësore.
- Është siguruar furnizim i qëndrueshëm i Kujdesit Parësor Shëndetësor me barna dhe material shpenzues nga Lista e barnave esenciale.
- Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve testuese që krijojnë parakushte për licencim të institucioneve private, MSH-ja ka miratuar Udhëzimin Administrativ nr.01/2020, për

plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 09/2014 -kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale të institucioneve private shëndetësore jashtë spitalore, udhëzimin administrativ (në Shëndetësi) nr.02/2020 – Për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore dhe udhëzimi administrativ nr. 03/2020 për plotësim ndryshimin e UA 08/2017 organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtaritë e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor.

- Me qëllim të zbatimit të akteve nënligjore që i paraprijnë “Licencimit të institucioneve private shëndetësore për të kryer teste për COVID-19, Ministri i Shëndetësisë ka themeluar: Bordin për Licencimin e Institucioneve private shëndetësore dhe Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve dhe institucioneve private shëndetësore. Bordi për Licencimin e Institucioneve Private Shëndetësore, ka filluar shqyrtimin e kërkesave të Institucioneve Private shëndetësore të cilat kanë kërkuar leje për kryerjen teste për SARS CoV-2. Bordi ka aprovuar deri me datë 29 Shtator 2020 kërkesat e 126 institucioneve private shëndetësore për kryerje të teste për SARS COV 2 (122 për teste serologjike dhe 4 për teste molekulare PCR). Deri tani (fundi i shtatorit 2020), në laboratorët private janë kryer afër 3 mijë teste molekulare si dhe 20 mijë teste serologjike.
- Janë miratuar kërkesat për pagesat shtesë për të punësuarit në institucionet shëndetësore, të cilët përfshijnë tri nivelet e përkujdesjes shëndetësore, deri në fund të vitit 2020, bazuar në ligjin Anti Covid, për muajt shtator-dhjetor të jenë si në vijim: Mjekët – 250 euro në muaj, Infermierët – 150 euro në muaj, Staf mbështetës – 100 euro në muaj. Gjithashtu, është arritur pajtimi që në fillim të vitit të ardhshëm, të diskutohen mundësitë për pagesën shtesë për kohën sa do të zgjasë pandemia me Covid 19, në territorin e Kosovës.
- Janë angazhuar resurse humane shtesë në institucionet shëndetësore. Fillimisht janë rekrutuar 200 specialistë shëndetësorë (100 mjekë - në mesin e të cilëve edhe mikrobiologë, 62 infermierë, 20 inspektorë sanitarë, 4 specialistë të mikrobiologjisë, 8 laborantë dhe 6 të tjerë - staf teknik mbështetës). Ndërkaq, përmes riorganizimit të Projektit të Shëndetësisë Kosovare (huamarrja nga Banka Botërore) janë rekrutuar edhe 375 profesionistë të fushave të ndryshme mjekësore dhe staf mbështetës, në funksion të fuqizimit të kapaciteteve njerëzore profesionale

- Është nënshkruar marrëveshja për mbështetje të kujdesit parësor shëndetësor me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që do të realizohet deri në dhjetor 2023, me vlerë 8.8 milion franga zvicerane, marrëveshja për grant me Japoninë për pajisje në vlerë prej 800 mijë euro, Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë – Faza II- KSV/017 si dhe është nënshkruar marrëveshja me Fondin Global për programet HIV dhe TB.
- Është miratuar Plani Strategjik për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2021, Plani Strategjik për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin riprodhues 2021, si dhe Plani i Veprimit për Parandalimin e Infeksioneve Spitalore.
- Janë miratuar tre udhërrëfyes klinik, të cilët ndihmojnë profesionistët shëndetësor në trajtimin bashkëkohor të sëmundjeve si: Iskemia trunore, Hepatiti C dhe Diabeti Tip-2 të rriturit, duke u bazuar në të dhëna dhe dëshmi shkencore.
- Është prezantuar projekti i finalizuar për ndërtim të Spitalit të Podujevës, që do të ketë sipërfaqe rreth 7 mijëe700 m2 dhe do të ofrojë shërbimet si: Diagnostika (Laboratorët me Radiologji), Ambulancat Specialistike, Shërbimi Emergjent, Mjekësia Interne, Kirurgji dhe Ortopedi, Gjinekologji dhe Neonatologji dhe Pediatri.
- Është miratuar projektligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, është hartuar projektligji për shëndet riprodhues dhe fertilizimin e asistuar dhe projektligji për shëndetësi.
- Janë miratuar dhe nënshkruar Udhëzimi Administrativ (në shëndetësi) nr. 03/2020 - Për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 08/2017 – Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor, me çka është mundësuar ligjërisht që testimet serologjike për antitropa për detektim të SARS COV-2 të kryhen në KPSH dhe në sektorin privat, Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr.01/2020, për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 09/2014 -kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale të institucioneve private shëndetësore jashtë spitalore dhe Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr.02/2020 – për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrative 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore. Sa i përket standardeve janë miratuar 11 udhërrëfyes dhe protokolle klinike.

8. Bujqësia dhe zhvillimi rural

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të programit të saj dhe në mbështetje të qytetarëve dhe bizneseve të angazhuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të cilët i ka dëmtuar pandemia COVID019, ka ndërmarrë masa ndihmuese dhe lehtësuese në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Janë zhvilluar modulet online për aplikim me qëllim të rritjes së transparencës dhe menaxhimit më të mirë të zbatimit të Programit të Zhvillimit Rural dhe ruajtjes së shëndetit të fermerëve, si rrjedhë e pandemisë COVID-19.
- Janë miratuar 198 projekte (pemë dhe perime/serre) në thirrjen e parë për aplikim të Masës 101: Investime në asetet fizike në ekonomitë bujqësore/ investimet ne nivel ferme.

Programi për zhvillim rural 2020-21, thirrja e pare për aplikim		% e mbështetjes publike	Nr. i projekteve të miratuara
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore 198			
101.1	Pemë drufrutore	60	66
101.2.1	Pemë arrore (arra, lajthia)	60	20
101.2.1	Sektorin e perimeve dhe serrave	60	112
Masa 103: investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore 22			
103.1	Përpunimi i qumështit	50	3
103.2	Përpunimi i mishit	50	4
103.3	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	50	11
103.4	Prodhimi i verës	50	4
Masa 302: diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale 127			
302.1	Prodhimi i mjaltit	65	52
302.3	Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	65	23
302.4	Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	65	15

302.7	Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	65	37
Masa	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	80	1
Totali			348

- Janë miratuar 22 projekte në industrinë e përpunimit të ushqimit (mish, qumësht, pemë dhe perime përfshirë edhe verën) në thirrjen e parë për aplikim të Masës 103: investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore.
- Janë miratuar 131 projekte (prodhimi i mjaltit, përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare, zhvillimi i aktiviteteve artizanale, rritja e shpezëve për vezë dhe për mish) në thirrjen e parë për aplikim të Masës 302: diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale.

Nën masat e thirrja e pare për aplikim te cilat janë aprovuar		127		Nen masat e thirrjes se dyte për aplikim e cila është përgatitë për publikuar
302.1.	Prodhimi i mjaltit	52	302.2.	Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jo drusore të malit
302.2	Përpunimi i prodhimeve bujqësore shtëpiake	23	302.4.	Zhvillimi i aktiviteteve artizanale
302.4.	Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	15	302.6.	Akuakultura/kultivimi i peshkut
302.7	Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	37		

- Është hartuar Programi për Pagesa Direkte për vitin 2020 në tre sektorë të bujqësisë: drithëra, hortikultura dhe blegtori. Janë përkrahur 28 mijë e 600 fermer në shumën totale të buxhetit prej 35 milion e 102 mijë e 277 euro e 17 cent. Kurse në proces të realizimit është edhe faza e dytë e Pagesave Direkte, pjesë e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike për Sektorin e Bujqësisë.
- Janë realizuar gjithsej 5 mijë e 96 testime laboratorike të fushave të ndryshme me ndikim në sigurinë ushqimore (mbrojtjen e bimëve, tokës, plehrave dhe ujit për ujitje, cilësia e farërave, cilësia e ushqimit dhe mbetjeve kimike).

- Është hartuar Master Plani për ujitjen e tokave bujqësore.
- Është promovuar integrimi vertikal dhe zhvillimi i zinxhirit të vlerës nga prodhimi te fermeri- përpunimi i produkteve ushqimore e deri të tregtimi/depot ruajtëse dhe marketet. Përmes promovimit të kontaktimit të prodhueseve dhe përpunuesve, të cilët janë përfitues të projekteve nga PZHR- ja dhe marketeve në anën tjetër parashihet që të realizohen rreth 800 -1000 kontrata në mes të prodhuesve, përpunuesve dhe tregtarëve.
- Është bërë shumë për diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve rurale ku janë miratuar 127 projekte që synojnë krijimin dhe zhvillimin e aktiviteteve alternative ekonomike në zonat rurale, promovimin dhe zhvillimin e biznesit të produkteve jo-bujqësore, përmirësimin e qasjes në shërbime të fermave bujqësore dhe popullsisë rurale, si dhe promovimi i turizmit rural.
- Janë pranuar 31 kërkesa, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore për aktivitete jo bujqësore si dhe gjatë periudhës raportuese janë dhënë 20 pëlqime, 6 refuzime dhe 8 lëndë janë në procedurë të shqyrtimit.
- Janë duke u realizuar Planet Menaxhuese Pyjore (PMP) për gjithsej rreth 10 mijë e 850 hektarë pyje në 5 Njësi Menaxhuese.
- Janë angazhuar gjithsej 290 punëtorë, për një periudhë dy mujore. Angazhimi i tyre është bërë në periudhën e aktiviteteve në përfundim të vitit, në këto aktivitete: damkimin e masës drusore në sasi prej rreth 55 mijë m³, në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, në krasitje dhe mirëmbajtje të brezave kundër zjarreve si dhe krasitja e degëve në pyjet e reja.
- Janë prodhuar rreth 1 milion e 395 mijë fidane. Duke u pyllëzuar gjithsej 374 hektarë, (prej tyre 139 hektarë me punëtorë sezonal, dhe 235 hektarë përmes operatorëve ekonomik të kontraktuar);

9. Infrastruktura, energjia, minierat, ujërat dhe ambienti

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, ka ndërmarrë masa në sektorin e infrastrukturës, energjisë, minierave, ujërave dhe ambientit, për lehtësimin e transportimit të njerëzve dhe mallrave, efikasitetin e energjisë, shfrytëzimin e duhur të mineraleve, ujit të shëndetshëm dhe mjedisit të pastër. Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është nënshkruar projekti për rehabilitimin e rrugës “Hyrja në Qytetin e Ferizajt”, që është kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Gjatësia e projektit është 5.6 kilometra me katër korsi dhe do ta ketë ndriçimin, trotuaret dhe të gjitha standardet.
- Është shpallur tenderi për rrugën Kijevë – Zahaq dhe ka vazhduar rehabilitimi gjeneral (punët ndërtimore) për fazën e parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë–Hani i Elezit).
- Gjatë periudhës raportuese MI në sferën e infrastrukturës rrugore, ka përgatitur detyrat projektuese për hartimin e projekteve zbatuese dhe të njëjtat i janë dhënë kompanisë projektuese për projektet: Hartimi i Projektit për Zgjerimin e rrugës R101(Mitrovicë-Pejë), Segmenti Mitrovicë-Skënderaj; Projekti për zgjidhjen e pjesës së rrugës dhe murit mbrojtës në Veternik; Hartimi i projektit për Zgjerimin e rrugës N25-segmenti Prishtinë-Rreth-rrotullimi Besi; Hartimi i projektit për Zgjerimin e rrugës N2 –QMI deri në hyrje të Lipjanit; Hartimi i projektit të rrugës ‘A ‘ - K. Prishtinës; Punimi i detyrës projektuese për Hartimin e projektit zbatues për zgjerimin me katër shirita të rrugës nacionale Mitrovicë-Leposaviq - Kufiri me fqin verior.
- Janë përgatitur kërkesat për inicim të procedurave të prokurimit për projektet: Ndërtimi i urës në rrugën Nacionale N9, segmenti Pejë - Kuqishtë, lokacioni Drelaj; dhe Rregullimi i Ndriçimit në autostradën Morine-Merdare R7.
- Janë në përfundim e sipër procedurat e përzgjedhjes së kompanisë e cila do të bëjë rehabilitimin gjeneral (punët ndërtimore) të fazës së dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë), pas kësaj pritet vlerësimi nga BERZH –i dhe BE-ja në mënyrë që në kuartalin e parë të vitit 2021 të bëhet nënshkrimi i kontratës.

- Janë hartuar Termat e Referencës për hartimin e Projekt Dizajnit Detaj Teknik për Rehabilitimin dhe modernizimin e Fazës së Tretë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Mitrovicë – Leshak – kufiri me Serbinë).
- Është në përfundim Projekt dizajni preliminar për linjën e 7-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me fqinjtë verior), që pritet të përfundojë në kuartalin e parë të vitit 2021.
- Është në përfundim e sipër studimi i fizibilitetit për linjën Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës. Ky projekt pritet të përfundojë në kuartalin e parë të vitit 2021.
- Janë liruar nga pagesa-tarifa administrative operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve me autobus për periudhën 3 vjeçare, 2020-2023, për shkak të pandemisë COVID-19.
- Është nënshkruar marrëveshje bilaterale për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, e cila do të ofroj mundësi për qasje më të lehtë të operatorëve rezident në tregun evropian.
- Është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për ndërtimin e linjës hekurudhore ndërmjet dy vendeve, që padyshim do të mundësonte qasje më të lehtë dhe më të sigurt në portet detare.
- Është bërë menaxhimi i 21 projekteve të rrugëve nacionale me gjatësi prej 54.33km në total.
- Në rrugët rajonale është punuar në 11 projekte rrugore gjithsejtë 96.10km, ndërsa është punuar në 77 projekte të rrugëve lokale me gjatësi të përgjithshme prej 77km të financuara nga MI apo në bashkëfinancim me kuvendet komunale.
- Në kuadër të menaxhimit të rrugëve nacionale dhe rajonale, gjatë kësaj periudhe është punuar edhe në vendosjen e sinjalizimit vertikal në shtatë (7) rajone respektivisht katërbëdhjetë (14) nën-rajone të Kosovës.
- Kanë filluar edhe aktivitetet në sinjalizimin horizontal. Punët në sinjalizim vertikal dhe horizontal dhe pajisje rrugore janë kryer në pesë (5) Lote apo 912 (km) rrugë Nacionale dhe Rajonale.
- Është bërë mirëmbajtja e Autoudhëve R6 dhe R7 në gjatësi prej 148km dhe është punuar në mirëmbajtjen verore –MV të rrjetit rrugor nën përgjegjësinë e MI-se, ku është punuar në: mbylljen e gropave, pastrimin e vegjetacionit nga brezi rrugor, hapja e kanaleve

përgjatë rrugëve në gjithë Kosovën, mbledhja e mbeturinave në brezin rrugor si dhe në shtresimin e asfaltit në disa rrugë të degraduara bazuar në kontratat e mirëmbajtjes. Gjithashtu është bërë vendosja e pahive elastike në segmente të rrezikshme rrugore.

- Në kuadër të ekzekutimit të huamarrjes nga BERZH ka filluar ekzekutimi i punimeve në: Hyrje të qytetit e Gjilanit; hyrje të qytetit të Prizrenit dhe rehabilitimi i rrugës Kllokot - Gjilan në një vlerë të përgjithshme prej 14 milion euro. Projekti “Zgjerimi i rrugës kryesore M2 Milloshevë-Mitrovicë”: (1). Segmenti “Gojbulë - Smrekovicë”, huamarrje nga Banka Islamike për Zhvillim ka përfunduar në total me 20 Nëntor 2020. (2) Segmenti “Lumi Madh - Gojbulë”, huamarrje nga Fondi Saudit për Zhvillim dhe OFID, për shkak të problemeve me shpronësim progresi i realizimit fizik të punimeve ka ngec në 15%.

Në sektorin e energjisë janë ndërmarrë këto masa:

- Është hartuar Strategjia për Energji 2021-2030 dhe është duke u hartuar Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) 2021-2030.
- Janë përgatitur termat e referencës për studimin përbashkët të fizibilitetit për gazsjellësin Maqedoni Veriore-Kosovë, pas aprovimit të grantit nga Komiteti Drejtues i WBIF në vlerë prej 653 mijë e 250 euro.
- Janë përgatitur termat e referencës sa i përket planifikimit tjetër programor për gazin natyror, mbi bazën e rekomandimeve të dala nga studimi i përbashkët i parafizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë në lidhje me përgatitjen e Master Planit për shpërndarjen e gazit natyror në Kosovë, pas aplikimit dhe dakordimit të grantit përmes platformës WBIF në vlerën prej 1.5 mil Euro,
- Ka përfunduar faza e parë e projektit për dekomisionimin dhe çmontimin e azotikut, gazifikimit dhe ngrohtores në lokacionin e TC Kosova A.
- Janë duke u zbatuar masat e efikasitetit të energjisë në 27 objekte shkollore, me financim përmes BRK, me një vlerë të kontraktuar prej 1 milion e 670 mijë e 167 euro. Deri me tani nga komisionet mbikëqyrëse janë bërë pranimet për realizimet e punimeve sipas kontratave të ndara në 4 llote. Në kuadër të Programit zbatimi i masave të EE-së, janë mbështet financiarisht Komunitat-Deçan, Kamenicë dhe Ferizaj edhe në vitin 2020 në vlerë 619 mijë euro në fushën e ndriçim publik.

- Janë duke u zbatuar masat e EE-së në 30 objekte të institucioneve publike të cilat financohen përmes kredisë. Deri tani është realizuar rreth 76% e vlerës së kontratës. Është publikuar pakoja e 6-të e renovimit të 15 ndërtesave publike ku jemi në proces të vlerësimit të ofertave. Aktivitet tjetër i BB-së është krijimi i Këshillave banesore HOA për përgatitje e raporteve të auditimit dhe dizajneve për 19 ndërtesat rezidenciale e cila përfshinë vlerën 237 mijë euro, që është kompletuar 90% deri me tani. Publikimi i aktivitetit të ri “Përgatitja e studimit të tregut për Kompaninë e Kursimit të Energjisë (ESCO) në sektorin e banimit, shërbimin publik, privat, dhe industrisë “është bere gjate muajit dhjetor. Jemi në finalizim të dy kontratave të cilat përfundojnë në fund të vitit “Mbështetja për gjenerimin e Energjisë së ripërtëritshme të integruar në rrjet” më vlerë të kontratës 743 mijë e 577 euro si dhe “Kampanja për videon 3 minutëshe” më vlerë 19 mijë e 470 euro.
- Është përgatitur projekt-propozimi “Instalimi i Sistemeve Solare në Shkollat e Republikës së Kosovës” në 1 mijë e 216 shkolla nëpër komuna, në vlerë prej 20 milion e 3 mijë e 200 euro. Ky projekt është pjesë e planit investiv të Qeverisë 2021-2025. Gjithashtu, është përgatitur projekt propozimi “Qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose lëvizje të zvogëluar, në objektet publike në nivelin lokal” për 97 objekte komunale i cili do të financohet nga Komisioni Evropian.
- Ka filluar hartimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare(PZSM) për periudhën 2021-2023.
- Është publikuar raporti i treguesve mjedisor dhe raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë për vitin 2019 si dhe është përgatitur raporti për gjendjen e mjedisit 2018-2019, që është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe që është proceduar për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës.
- Është përgatitur inventari i burimeve të emisioneve në ajër dhe modelimi i shpërndarjes së ndotësve të ajrit për gjithë territorin e Kosovës, në kuadër të projektit për të dhënat mjedisore, që po zbatohet nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit-MCC (Millenium Challenge Cooperation),
- Është përgatitur specifikacioni teknik dhe është kontraktuar operatori ekonomik për realizimin e projektit “Avancimi dhe automatizimi i rrjetit ekzistues meteorologjik”, përmes të cilit do të instalohen 5 stacione meteorologjike për matje automatike dhe transfere të të dhënave në kohë reale.

- Në kuadër të programit të bashkëpunimit me Agjencinë e Mjedisit të Evropës, është realizuar raportimi për zonat e mbrojtura, për emisionet në ajër, për inventarin e gazrave serrë, për impiantet me djegie të mëdha, për cilësinë e ajrit, si dhe është përfshirë në Indexin Evropian të cilësisë së ajrit, raportimi në kohë reale i të dhënave të cilësisë së ajrit për 12 stacione monitoruese të rrjetit nacional të monitorimit.
- Është bërë furnizimi me 15 kamionë të rinj për mbledhjen e mbeturinave komunale për komunat: Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Suharekë, si ndihmë nga Japonia.
- Është finalizuar vlerësimi dhe është përgatitur Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe deponive ilegale në të gjitha komunat e Kosovës për vitin 2019. I finalizuar është edhe ndërtimi i impiantit për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave komunale në Komunën e Mitrovicës, një projekt me vlerë prej 3 milion euro.

Vlerësimi për shpërndarja e deponive ilegale sipas rajoneve 2018-2019

Nr.	Rajonet	Deponi ilegale gjithsej 2018	Deponi ilegale gjithsej 2019	Shtimi-eliminimi i deponive ilegale 2018-2019
R1	RAJONI I PRISHTINËS	582	313	-269
R2	RAJONI I MITROVICËS	221	222	1
R3	RAJONII PEJËS	342	141	-201
R4	RAJONI I PRIZRENIT	448	298	-150
R5	RAJONI I FERIZAJT	158	127	-31
R6	RAJONI I GJILANIT	377	325	-52
R7	RAJONI I GJAKOVËS	118	63	-55
KOSOVË		2246	1489	-757

- Është përgatitur baza e të dhënave për mbeturinat e rrezikshme industriale dhe kemikatet, janë mbledhur të dhëna për plotësimin e të dhënave si dhe është trajnuar stafi për mirëmbajtjen dhe plotësimin e këtyre të dhënave.
- Është finalizuar dhe është aprovuar nga ambasada suedeze në Kosovë, projekti i bashkëpunimit në mes të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Suedisë, në vlerë prej 9 milion SEK (korona suedeze).
- Ka përfunduar procesi i hartimit të dokumentit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.
- Është hartuar Harta Zonale e Kosovës, e cila është proceduar për miratim në Qeveri.
- Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të reformave të filluara me qëllim të unifikimit dhe qartësimin të procedurave për regjistrimin e pronës në kadastrë, janë ndërmarrë masat si në vijim: zhvillimi i modulit për regjistrimin automatik të hipotekave nëpërmjet Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), për nevoja të institucioneve financiare; është kapitalizuar bashkëpunimi mes AKK-së dhe Postës së Kosovës me vendosjen e zonave postare në sistem të adresave; është zhvilluar Ueb shërbimi i ndërtuar në sistemin e informacionit kadastral të AKK-së, i cili ofron të dhënat kadastrale për vlerësimin e tatimit në pronë; është zhvilluar edhe shtresa Covid-19 në sistemin grafik të të dhënave dhe është përditësuar dhe replikuar në Gjeoportali në baza ditore.
- Janë proceduar për kompensim të pronës gjithsej 207 lëndë me 327 raporte në vlerë financiare prej 10 milion e 854 mijë e 385 euro.
- Është miratuar Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZH) i një pjese të fshatrave Hade, Palaj, Sibovc, Shipitulle dhe Leshkoshiq, në sipërfaqe prej 129 ha dhe janë hartuar 15 Aktvendime për ndarjen e trojeve në Lokacionin Hade e Re në Shkabaj.

10. Mbrojtja dhe siguria publike

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, ka ndërmarrë masa në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, që përfshijnë ato për zbatimin e Planit të Përgjithshëm të Tranzicionit, marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorin e sigurisë, nëpërmjet të cilave avancohet korniza ligjore, forcohet lufta ndaj krimit dhe korrupsionit, bashkëpunimi ndërkombëtar, përgatitja e forcave për pjesëmarrje në misione paqeruajtëse, kontrolli kufitar dhe menaxhimi i integruar i kufirit si dhe rritja e integritetit të forcave të rendit.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është hartuar dhe miratuar në Këshillin e Sigurisë të Kosovës, Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2021-2030, si strategji ombrellë e sigurisë ku definohen objektivat strategjike të Kosovës në sektorin e sigurisë.
- Është hartuar Strategjia e Mbrojtjes, që ka për qëllim definimin e objektivave strategjike të mbrojtjes dhe zhvillimit të konceptit strategjik të mbrojtjes.
- Është hartuar Strategjia kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm 2021-2025.
- Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare në vlerën prej 1 milion e 598 mijë e 100 euro për zyrtarët aktiv policorë për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt në zbatimin e detyrave për menaxhimin e pandemisë. Kjo shumë e mjeteve financiare është ndarë për 6 mijë e 124 zyrtarë policorë në shumën prej 100 euro për secilin muaj në periudhën Tetor, Nëntor dhe Dhjetor.
- Janë realizuar 332 operacione, 42 plane operative, 610 bastisje nga ana e Policisë së Kosovës, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Si rezultat i kësaj, janë trajtuar 945 raste dhe janë paraqitur 434 kallëzime penale ndaj 727 personave.
- Është realizuar me sukses plani operativ në Karaqevë, ku janë arrestuar 12 zyrtarë policorë në luftën kundër krimit të organizuar.
- Janë arrestuar 799 persona të dyshuar për vepra të rënda penale dhe janë goditur 20 grupe kriminale.
- Janë sekuestruar 7.69 kg heroinë, 256 kg kokainë, 96 kg marihuanë dhe 2.85 kg amfetaminë, si dhe janë shkatërruar 5 mijë 579 bimë kanabisi.
- Është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, projektligji për deminim humanitar.

- Është miratuar koncepti dokumenti për dërgimin e pjesëtarëve të FSK-së në misione jashtë vendit dhe është hartuar koncepti dokumenti për policinë ushtarake.
- Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm të Tranzicionit, ka përfunduar procesi i riorganizimit të strukturës dhe janë realizuar lëvizjet në Shtab të Përgjithshëm, Komanda dhe Njësitë Vartëse.
- Ka përfunduar rekrutimi i 18 kadetëve në QSU dhe 8 kadetëve në akademitë jashtë Kosovës dhe është duke vazhduar rekrutimi i 400 të rekrutëve tjerë në FSK.
- Janë përfunduar 60 Kurse/Trajnime/Seminare të ndryshme me 119 pjesëtarë, në 6 shtete partnere të ndryshme. Janë duke vazhduar trajnimin 50 pjesëtarë në 30 Kurse/Trajnime të ndryshme, në 7 shtete partnere të ndryshme. 6 kadetë kanë përfunduar studimet në Akademi dhe Kolegje Ushtarake në 3 shtete partnere, ndërsa janë duke vazhduar 39 kadetë/pjesëtarë në Akademi/Kolegje Ushtarake në 5 shtete partnere të ndryshme. 14 kadetë kanë përfunduar studimet në qendrën e Studimeve universitare të FSK-së. Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes janë realizuar 46 Kurse/Trajnime specialitike me 970 pjesëtarë. Po ashtu, 80 pjesëtarë të FSK-së, kanë marrë pjesë në 3 Ushtrime Fushore jashtë vendit.
- Janë realizuar gjithsej 7 projekte, në vlerën totale prej 1 milion e 457 mijë e 140 euro e 73 cent. Sa i përket investimeve infrastrukturore, janë realizuar gjithsej 2 projekte, në vlerë prej 1 milion e 736 mijë e 686 euro e 57 cent. Sa i përket projekteve kapitale infrastrukturore, të investimeve në vijim, për periudhën 2020-21, janë gjithsej 4 projekte në vlerë të përbashkët të kontratave, me shumën prej 2 milion e 221 mijë e 79 euro e 07 cent.
- Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët strategjik, MM-ja dhe FSK-ja kanë marrë pjesë në konferenca dhe vizita të ndryshme, dhe kanë organizuar konferencën vendore “FSK dhe Partnerët 2020”.
- Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë me kontingjente prej 12 pjesëtarësh në ushtrimet “KFOR 27” dhe “KFOR 28” të zhvilluara në Gjermani në datat 16 Shkurt - 10 Mars 2020 si dhe 1 Tetor - 8 Nëntor 2020 nën organizimin “US Army Europe”.
- MM-ja dhe FSK-ja janë në proces të përgatitjeve që pjesëtarët e FSK-së t’i bashkohen trupave paqeruajtëse të ushtrisë Amerikane në Kuvajt dhe Irak dhe është në proces marrëveshja me SHBA-të për pjesëmarrje në operacionet e mbështetjes së paqen në

bashkëpunim më Gardën Kombëtare IOWA. Dislokimi i FSK –së planifikohet të realizohet në kuadër të Komandës Qendrore të Ushtrisë Amerikane (U.S. CENTCOM) e cila është përgjegjëse për operacionet ushtarake amerikane në Lindjen e Mesme, Irak dhe Afganistan.

- MM-ja dhe FSK-ja kanë pranuar donacione në vlerën totale prej 1 milion e 626 mijë e 435 euro e 60cent, për fushën e mbrojtjes.
- Në kuadër të MPB-së janë nënshkruar marrëveshjet: Marrëveshje Pune me EUROPOL, Marrëveshje e Punës në mes të MPB-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendrës Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA), si dhe Marrëveshje për Bashkëpunim Policor me MPB-në e Republikës Italiane. Këto marrëveshje do të sigurojnë: bashkëpunim të drejtpërdrejtë mes Policisë së Kosovës dhe EUROPOL, shkëmbimin e të dhënave dhe bashkëpunimin në fushën e drogave, si dhe do të përforcojë përpjekjet e përbashkëta të Kosovës dhe Italisë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit trans-nacional, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.
- Është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës Projekt-ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.05/L-015 për Letërnjoftim.
- Janë hartuar projektligji për tubimet publike me rekomandimet e dala nga Komisioni i Venedikut, projektligji për siguri kibernetike dhe projektligji për pensionimin e zyrtarëve policor, si dhe është avancuar korniza ligjore në sektorin e sigurisë, nëpërmjet miratimit të 24 akteve nënligjore.
- Janë pritur në mënyrë të organizuar 286 persona të riatdhesuar, ndërsa MPB-ja ka mbështetur me skema të riintegrit 956 persona të riatdhesuar. Nga skemat për integrimin e të huajve, kanë përfituar 19 persona me mbrojtje ndërkombëtare. Mes tjerash, është përditësuar Plani i Reagimit për Menaxhimin e ndonjë fluksi të mundshëm me emigrantë si dhe është finalizuar Rregullorja për përbërjen dhe funksionimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim. Për definimin e objektivave strategjike në fushën e migrimit, është hartuar Strategjia për Migrim 2021-2025, ku janë integruar edhe objektivat për riintegrimin e personave.

- Është nënshkruar projekti për “Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Ballkanin Perëndimor”, në vlerë prej 5 milion euro.

11. Mbrojtja sociale dhe integrimi në punësim

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, ka ndërmarrë masa për mbrojtje sociale dhe punësim, që përfshijnë ato për realizimin e skemave sociale të parapara me fondin për rimëkëmbje, skema të zakonshme sociale, rregullim të kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes sociale dhe punësimit, zhvillim të politikave të punësimit dhe masa për inspektime në sektorin publik dhe privat.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është realizuar e drejta në ndihmë sociale për mbi 24 mijë e 500 familje, me rreth 100 mijë anëtarë, të cilët kanë përfituar ndihmë sociale në bazë të numrit të anëtarëve të familjes nga 60-180 euro në muaj, si dhe nga 5 euro shtesë për familjet që kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.
- Në kuadër të zbatimit të masave të Pakos Emergjente Fiskale, është zbatuar skema e re e asistencës mujore për familjet pa të ardhura, e realizuar tek rreth 30 mijë familje, me një shumë mbi 12 milionë euro. Shuma totale e mbështetjes për pagesën e rregullt të familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale për vitin 2020, ka qenë mbi 31 milion euro, ndërsa shuma e dyfishimit të pagesave që janë realizuar për familjet në skemën e ndihmës sociale për gjashtë muaj nga dy pakot ka qenë rreth 15 milion euro.
- Është realizuar pagesa e kompensimeve për familjet që kujdesën për fëmijët me aftësi të kufizuar nga e cila skemë kanë përfituar pagesë në shumë prej 100 euro mbi 2 mijë e 288 fëmijë me aftësi të kufizuara. Nga ky program kanë përfituar pagesë në shumën prej 100 euro mbi 550 fëmijë pa kujdes prindëror dhe pagesë në shumë prej 250-350 euro rreth 60 fëmijë të braktisur. Shuma e mbështetjes për këto skema nga Buxheti i Kosovës për vitin 2020 duke përfshirë edhe shtesën nga Pako Emergjente Fiskale, ka qenë rreth 4 milion euro.
- Nga skema për ndihmë të njëhershme/emergjente kanë përfituar rreth 72 individë/familje. Shuma për këtë lloj përkrahje është 100 euro shuma minimale, dhe 300 euro shuma maksimale.

- Është bërë subvencionimi i energjisë së shpenzuar elektrike për familjet që përfitojnë nga Skema e Ndhmës Sociale (SNS), Skema e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës (FDIL), Skema për Personat e Verbër (SPV) dhe Skema për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik (SPPT) për vitin 2019. Nga kjo marrëveshje kanë përfituar mbi 36 mijë familje. Shuma totale e mjeteve të shpenzuara është 4,5 milion euro.
- Janë mbështetur dhe financuar 10 strehimore dhe 29 organizata të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ku shuma e mbështetjes për këtë vit ka qenë rreth 800 mijë euro.
- Është hartuar koncept dokumenti për Reformimin e Skemës së Ndhmës Sociale dhe janë aprovuar katër projekt rregullore në fushën e ndërmarrësisë sociale, të cilat janë: projekt rregullorja (QRK) nr.17/2020 për Procedurat e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Sociale, projekt rregullorja (QRK) nr.18/2020 për Procedurat e Raportimit për Arritjen e Objektivave Sociale dhe Raportet Financiare, projekt rregullorja (QRK) nr.19/2020 për Procedurat e Marrjes, Refuzimit dhe Humbjes së statusit të Ndërmarrjes Sociale, projekt Rregullorja (QRK) nr.20/2020 për strukturat përgjegjëse të monitorimit, kontrollit dhe procedurat për gjoba dhe ankesa të ndërmarrjeve sociale.
- Është hartuar drafti i Koncept Dokumentit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social, dhe është hartuar Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuar nga shteti.
- Është nënshkruar marrëveshja për sigurime sociale ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës dhe është arritur marrëveshja mbi mobilitetin në punë, të negociuar midis Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave të Shqipërisë.
- Është finalizuar rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Sektoriale për periudhën 2021-2022, është përgatitur Politika e Punësimit e cila ka për qëllim rritjen e performancës së shërbimeve publike të punësimit, si dhe është hartuar për herë të parë draft Strategjia ndër-sektoriale për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2021-2026 dhe Plani i Veprimit.
- Në kuadër të statistikave të punësimit, numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar nga shërbimet publike të punësimit deri me 15 dhjetor 2020 është rreth 201 mijë 935 persona. Agjencia e Punësimit përmes Zyrave të Punësimit deri me 15 Dhjetor 2020, kanë

regjistruar 10 mijë e 302 vende të lira të punës, ndërsa numri i përgjithshëm i ndërmjetësimeve në punësim është rreth 6 mijë e 854.

- Është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës projektligji i punës dhe projektligji për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror, projektligji për Inspektoratin e Punës dhe projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-004 për Këshillin Ekonomiko Social.
- Është miratuar koncept dokumenti për përmirësimin dhe avancimin e legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë ndërsa është hartuar koncept dokumenti për dërgimin/sistemin e punëtorëve të huaj në Republikën e Kosovës (Posting of Workers).
- Janë hartuar projekt udhëzimi administrativ për rregullimin dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për regjistrimin e organizatave sindikale, projekt udhëzimi administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2011, për regjistrimin e marrëveshjeve kolektive ndërsa ka miratuar 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për vendet e punës, projekt rregullorja Nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për pajisjet e punës, projekt rregullorja e re për certifikimin dhe licencimin e personave të cilët ushtrojnë aktivitete nga fusha e SSHP, si dhe projekt rregullorja e re për vlerësimin e riskut në vendin e punës.
- Janë realizuar mbi 6 mijë e 505 inspektime në të cilat janë përfshirë mbi 24 mijë e 689 të punësuar si dhe janë trajtuar rreth 10 mijë e 779 kërkesa të sektorit publik dhe sektorit privat, ankesa të parashtruara në lidhje me cenimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës por edhe nga siguria dhe shëndeti në punë.

12. Kultura, rinia dhe sporti

Qeveria e Republikës së Kosovës, në përmbushje të Programit të saj, ka ndërmarrë masa në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përfshirë ato për ndërtimin e stadioneve dhe qendrave të ndryshme sportive, përkrahjes së kinematografisë, mbështetjes të punësimit dhe ndërmarrësisë të të rinjve dhe trashëgimisë kulturore.

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto fusha, janë:

- Është bërë renovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, është përmbushur faza e parë e ndërtimit të objektit të Qendrës së Kulturës “Ukë Bytyqi” në Suharekë dhe është përfunduar Qendra Kulturore Rinore në Han të Elezit.
- Është nisur ndërtimi i Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” në Vushtrri, ka nisur rinovimi i kulmit të Shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina” në Skënderaj, të cilat janë në prag të përfundimit dhe është lidhur kontrata me operatorin ekonomik për rinovimin e Teatrit Kombëtar të Kosovës.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës për bashkëpunimin e ndërsjellë për Muzeun e Historisë së Natyrës dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit për bursa. Bazuar në marrëveshje, paneli vlerësues ka përmblyllur procesin duke përzgjedhur 6 bursistë: 3 për studime në fushën e arkeologjisë-periodha e parahistorisë, 1 për studime në arkeologji, 1 për studime të periudhës së antikitetit të vonë dhe mesjetë e hershme, 1 për studime të larta mbi letrat klasike.
- Janë ndërmarrë të gjitha veprimet për të nisur, zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar programin e punësimit për të rinj, që është zhvilluar përmes katër skemave të punësimit si dhe një sërë aktivitetesh të nevojshme si: përgatitja e termave të referencës për trajnime në ndërmarrësi, vlerësimin e projekteve, koordinimin e të gjitha aktiviteteve, monitorimin si dhe vlerësimin e rezultateve.
- Në kuadër të Planit të Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve 2018-2020 janë zhvilluar gjithashtu tri skema për rritjen e punësimit për rini: skema e shkathtësive të buta në të cilën janë trajnuar rreth 100 të rinj, skema e trajnimeve për ndërmarrësi, në të cilën janë trajnuar 500 të rinj, si dhe skema e trajnimeve ku janë certifikuar në programin e trajnimeve profesionale që synon rritje e aktivitetit të të rinjve nëpërmjet rritjes së punësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale e që në përputhje me nevojat e tregut

të punës është 755 të rinj. Janë mbështetur 162 të rinj për të hapur biznese e tyre start-up dhe janë përkrahur 74 organizata me projekt propozimet e tyre, në vlerë totale prej 230 mijë euro.

- Ka filluar renovimi i Stadiumit “Adem Jasharit” në Mitrovicë, kategoria IV sipas UEFA/FIFA dhe ka nisur ndërtimi i fushave të tenisit në Ferizaj, ka përfunduar rregullimi stadiumit në Kamenicë dhe është përruar Stadiumi në Runik.
- Ka filluar ndërtimi i Stadiumeve të Futbollit në Gjilan, Suharekë, Drenas, Han të Elezit, Shtime, Lipjan, Podujevë, Novosellë të Pejës, Prizren, dhe Kaçanik.
- Ka nisur ndërtimi i sallave të sporteve në Vrellë të Istogut, Zhipotok të Dragashit, Greme të Ferizajt, Drenoc, Skenderaj, Kaçanik, Viti, Dragash, Pejë, Lipjan, Podujevë dhe Fushë Kosovë.
- Janë ndihmuar 656 klube gjithsejtë me 1 milion e 434 mijë e 200 euro, nga ndihma financiare prej fondit për rimëkëmbje ekonomike.
- Është hartuar Koncept Dokumenti për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Rregullorja për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2012 për Dhënien përkatësisht marrjen e Lejes së Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave, udhëzuesi për Shoqatat për Administrimin e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta dhe është miratuar Rregullorja për Kompetencat, Autorizimet dhe Procedurat e Inspektimit dhe të Ankesave të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore
- Është miratuar Ligji për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, është hartuar plotësim ndryshimi i Ligjit për Arkivat Shtetërore dhe është hartuar plotësim ndryshimi i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.
- Janë nënshkruar 153 Memorandume të Bashkëpunimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me te cilat janë mbështetur veprimtari të ndryshme duke përfshi komunitet, federatat sportive, sportistet, trajnerët si dhe institucione të tjera.
- Janë nënshkruar pesë (5) marrëveshje ndërkombëtare: Kalendari i Përbashkët Kulturor Vjetor ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë; Marrëveshja për Bashkëprodhim të Filmit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë; Memorandum Bashkëpunim në fushën e Librit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe

Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë; Memorandum Bashkëpunim në fushën e Sportit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë për mbështetje Ligës së Përbashkët të themeluar ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit; dhe Marrëveshja për Bashkëprodhim Kinematografik mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë.

- Janë mbështetur 38 projekte, të cilat kanë sjellë risi për sa i përket situatës aktuale të pandemisë. Projektet kryesisht i kushtojnë rëndësi të veçantë vizualizimit të trashëgimisë kulturore në përgjithësi. Buxheti për mbështetje të projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore për Individ është 70 mijë e 350 euro ndërsa për OJQ është 186 mijë euro.
- Janë mbështetur individ dhe organizata jo-qeveritare në vlerë financiare prej mbi 80 mijë euro, për shënimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane.
- Janë mbështetur edhe 19 projekte të individëve në vlerë financiare prej mbi 100 mijë euro, për subvencionim në fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit.
- Sa i përket kinematografisë gjatë kësaj periudhe një numër i konsiderueshëm i filmave të financuar në bashkëprodhim nga QKK-në kanë përfaqësuar Kosovën në festivalet më prestigjioze të filmit në botë, si: ‘Galaktika e Andromedës’, filmi debutues nga More Raça dhe ‘Exil’ nga Visar Morina ishin pjesë e kategorisë kryesore në edicionin e sivjetmë të Festivalit të Sarajevës. ‘Exil’ në Sarajevë ka fituar çmimin kryesorë të festivalit ‘Zemrën e Sarajevës’ në një ceremoni të organizuar online për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.
- Është përfaqësuar Kosova në festivalet më të rëndësishme të botës, si në Festivalin e Sarajevës, Work in Progress, Bern, War on Screen IFF, Chalons en Champagne!, Sundance, Cairo International Film Festival, Critics Week Competition, Berlinale, Toronto dhe Sydney, me filmat “Galaktika e Andromedës”, “Exil”, “Zana” dhe “Cirku flututues”. Përveç çmimeve ndërkombëtare filmi “Exil” nga Visar Morina është nominuar për Oscar 2021.
- Ndërtesa e Ish Burgut të Prishtinës është shpallur Muze dhe është hapur për vizitorë.
- Janë miratuar Plani i menaxhimit për Qendrën Historike te Prizrenit dhe Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit.


Shtojca I: Të dhënat për COVID-19 Qershor - Dhjetor 2020

Numri i rasteve pozitive dhe negative me COVID-19 nga 01.06.2020 deri më datën 10.12.2020.


Nga data 01.06.2020 deri me 10.12.2020, janë testuar gjithsej 145 mijë e 301 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2. Testimi në numër kaq i madh është bërë me qëllim të gjurmimit të të gjitha kontakteve të rasteve të konfirmuara të cilat janë gjetë në mënyrë proaktive nga ekipet e IKSHPK. Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar gjithsej 44 mijë e 511 raste (incidenca 2500.6/100.000) dhe janë raportuar 1 mijë 144 raste të vdekjes (vdekshmëria 64.3/100.000). (Tabela 1, Graf. 1 dhe 2).

Tabela 1. Numri i rasteve pozitive dhe negative me COVID - 19 nga 01.06.2020 deri me datën 10.12.2020

Javet	Data	Pozitive	Negative	Total i mostrave	Vdekjet	Numri i banorëve	Raste në 100.000 banorë	Vdekje në 100.000 banorë
Java 1	01.06.2020-07.06.2020	151	1555	1706	1	178000	8.5	0.1
Java 2	08.06.2020-14.06.2020	252	1586	1838	2	178000	14.2	0.1
Java 3	15.06.2020-21.06.2020	683	2283	2966	3	178000	38.4	0.2
Java 4	22.06.2020-28.06.2020	508	1413	1921	13	178000	28.5	0.7
Java 5	29.06.2020-05.07.2020	831	1075	1906	26	178000	46.7	1.5
Java 6	06.07.2020-12.07.2020	1423	1488	2911	27	178000	79.9	1.5
Java 7	13.07.2020-19.07.2020	946	2379	3325	37	178000	53.1	2.1
Java 8	20.07.2020-26.07.2020	1536	1642	3178	46	178000	86.3	2.6
Java 9	27.07.2020-02.08.2020	1636	1509	3145	71	178000	91.9	4.0
Java 10	03.08.2020-09.08.2020	1370	1917	3287	85	178000	77.0	4.8
Java 11	10.08.2020-16.08.2020	1126	2155	3281	69	178000	63.3	3.9
Java 12	17.08.2020-23.08.2020	1002	2244	3246	70	178000	56.3	3.9
Java 13	24.08.2020-30.08.2020	907	2467	3374	45	178000	51.0	2.5
Java 14	31.08.2020-06.09.2020	750	2558	3308	43	178000	42.1	2.4
Java 15	07.09.2020-13.09.2020	488	3494	3982	32	178000	27.4	1.8
Java 16	14.09.2020-20.09.2020	450	3732	4182	15	178000	25.3	0.8
Java 17	21.09.2020-27.09.2020	378	3639	4017	10	178000	21.2	0.6
Java 18	28.09.2020-04.10.2020	335	3914	4249	7	178000	18.8	0.4
Java 19	05.10.2020-11.10.2020	392	4023	4415	16	178000	22.0	0.9
Java 20	12.10.2020-18.10.2020	762	4836	5598	8	178000	42.8	0.4
Java 21	19.10.2020-25.10.2020	1139	6065	7204	10	178000	64.0	0.6
Java 22	26.10.2020-01.11.2020	2517	6448	9058	31	178000	141.4	1.7
Java 23	02.11.2020-08.11.2020	4127	7207	11334	71	178000	231.9	4.0
Java 24	09.11.2020-15.11.2020	5013	7316	12329	65	178000	281.6	3.7
Java 25	16.11.2020-22.11.2020	5135	7176	11917	93	178000	288.5	5.2
Java 26	23.11.2020-29.11.2020	4656	6604	11260	90	178000	261.6	5.1
Java 27	30.11.2020-06.12.2020	3728	6368	10096	104	178000	209.4	5.8
Java 28	07.12.2020-10.12.2020	2270	2813	6268	54	178000	127.5	3.0
TOTALI		44511	99906	145301	1144		2500.6	64.3



Grafikoni 1. Rastet pozitive dhe vdekjet COVID-19, 01.06-10.12.2020, Kosovë




Grafikoni 2. Ecuria e rasteve me COVID-19 sipas javëve, 01.06-10.12.2020, Kosovë

Nga 44 mijë e 511 raste të konfirmuara grup-mosha më e prekur ka qenë 30-39 vjeç me 8 mijë e 876 raste (19.9%), pasuar nga grup-mosha 40-49 me 8 mijë e 3 raste (18%). Në grup-moshën mbi 65 vjeç kanë qenë gjithsej 6 mijë e 990 raste pozitive (15.7%). Më pak të prekur kanë qenë mosha nën 1 vjeç me gjithsej 33 raste (0.1%). Mosha shkollore (5-19 vjeç) paraqiten me gjithsej 3 mijë e 143 raste (7.0%). Analizuar në aspektin gjinor, në total më të prekur kanë qenë meshkujt me 51.3%. Mosha mesatare e të prekurve ka qenë 44.7 (44.7±18.0) vjeç me një dallim shumë të lehtë në mes të gjinive (M: 45.6±18.1; F: 43.9±17.9) (Tabela 2, Graf. 3)

Tabela 2. Rastet COVID-19 sipas grup-moshave dhe gjinisë 01.06-10.12.2020, Kosovë

Grup mosha	Femra	Meshkuj	Gjithsej	
			N	%
nën 1 vjeç	15	18	33	0.1
1-4	93	85	178	0.4
5-9	273	278	551	1.2
10-19	1323	1269	2592	5.8
20-29	3478	2973	6451	14.5
30-39	4431	4445	8876	19.9
40-49	3693	4310	8003	18.0
50-59	3603	3681	7284	16.4
60-64	1630	1923	3553	8.0
65+	3142	3848	6990	15.7
Total	21681	22830	44511	100.0
Mosha mesatare±DS	43.9±17.9	45.6±18.1	44.7±18.0	




Grafikoni 3. Rastet COVID-19, sipas grup-moshës dhe gjinisë, 01.06-10.12.2020, Kosovë

Që nga data 01 qershor 2020 deri më 10 dhjetor 2020, janë raportuar gjithsej 1 mijë e 144 raste të vdekjes nga COVID-19. Sipas grup-moshës, më së shumti të vdekur ka pas në grup-moshën mbi 65 vjeç me gjithsej 806 raste (70.5%), pasuar nga grup-mosha 50-59 vjeç me 145 raste (12.7%). Sipas gjinisë, rastet e raportuara të vdekjeve më së shumti janë të gjinisë mashkullore me gjithsej 759 raste (66.3%) krahasuar me gjininë femërore me gjithsej 385 raste (33.7%). Moshë mesatare e të vdekurve në total ka qenë 69.3 vjeç (69.3 ± 11.3). (Tabela 3 dhe Graf. 4)

Tabela 3. Rastet e vdekjeve COVID-19 sipas grup-moshave dhe gjinisë 01.06.2020-10.12.2020

Grup mosha	Femra	Meshkuj	Gjithsej	
			N	%
nën 1 vjeç	1		1	0.1
20-29	4	2	6	0.5
30-39	6	12	18	1.6
40-49	9	20	29	2.5
50-59	42	103	145	12.7
60-64	44	95	139	12.2
65+	279	527	806	70.5
Total	385	759	1144	100.0
Moshë mesatare \pm DS	69.6 \pm 12.1	69.1 \pm 10.8	69.3 \pm 11.3	




Grafikoni 4. Rastet e vdekjeve COVID-19 sipas grup-moshave dhe gjinisë 01.06-10.12.2020

Nga rastet e konfirmuara pozitive, sipas komunave dhe vendbanimeve janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë. Komuna më e prekur rezulton të jetë komuna e Prishtinës me gjithsej 17 mijë e 778 raste të konfirmuara me COVID-19, pasuar nga komuna e Gjilanit me 2 mijë 817 raste dhe komunat Ferizaj, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Prizren, Vushtrri, Mitrovicë dhe Pejë, siç janë të prezantuara në Tabelën 4 dhe Grafikun 5.

Tabela 4. Rastet COVID-19 sipas komunave dhe gjinisë 01.06-10.12.2020

Komuna	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Deçan	237	271	508
Dragash	79	126	205
Drenas	390	540	930
Ferizaj	994	1051	2045
